



# **Projekti i Reformës në Administratën Publike– Shqipëri**

**Shërbime Këshillimore për të përmirësuar Funkcionet Publike të**

**Institucioneve qendrore**

**Raport mbi strukturën funksionale të**

**Ministrisë së Punëve të Jashtme**

Prill 2006

## **Përmbajtja**

<b>Shënim</b> .....	iii
Fletë përmbledhëse e projektit.....	i
Përmbledhje e propozimeve tona për Ministrinë e Jashtme .....	ii
1.0 Misioni dhe prioritetet e Ministrisë së Punëve të Jashtme.....	1
1.1 Prioritetet e Politikës së Jashtme.....	1
1.2 Objektivat e Politikës së jashtme për 4 vitet e ardhshme .....	2
2.0 Struktura aktuale e MPJ.....	7
2.1 Drejtoria Politike, Ekonomike dhe e Sigurisë.....	7
2.1.1 Drejtoria e Përgjithshme e Marëdhënieve Dypalëshe.....	8
2.1.2 Drejtoria e Marëdhënieve me Vendet Fqinjë .....	9
2.1.3 Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Shumëpalëshe .....	9
2.1.4 Drejtoria e NATO-s.....	10
2.1.5 Drejtoria për Promovimin Ekonomik e Kulturor.....	11
2.1.6 Drejtoria e Bashkimit Europian .....	12
2.2 Drejtoria Konsullore dhe Juridike.....	12
2.2.1 Drejtoria e Protokollit të shtetit.....	12
2.2.2 Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Ligjore dhe Politikave Konsullore.....	14
2.3 Drejtoritë administrative .....	16
2.3.1 Drejtoria e Buxhetit, financës & Shërbimeve .....	16
2.3.2 Drejtoria e Auditimit të brendshëm dhe Inspektimit .....	17
2.3.3 Drejtoria e Personelit dhe Arkivës .....	17
2.3.4 Drejtoria e Shtypit dhe Diplomacisë Publike.....	17
2.3.5 Drejtoria e Shërbimeve të Trupit Diplomatik .....	18
2.3.6 Zyra për Ndërkomunikimin, Koordinimin e Përfaqësimit dhe Sekretariatit Qendror .....	19

3.0	Ristrukturimi i Ministrisë për përmirësimin e funksionalitet të saj .....	20
3.1	Çështje të sigurisë .....	20
3.2	Marëdhëniet Dypalëshe .....	22
3.3	Marëdhëniet me Europën .....	24
3.4	Çështjet Shumëpalëshe dhe Ekonomike .....	26
3.5	Çështjet globale .....	27
3.6	Çështjet Ekonomike .....	28
3.7	Shërbimet për Trupin Diplomatik .....	30
3.8	Çështjet Konsullore, Ligjore dhe Protokolli .....	30
3.8.1	Çështjet ligjore .....	30
3.8.2	Çështjet Konsullore .....	31
3.9	Funksionet administrative .....	31
3.9.1	Financa, Buxheti dhe Auditimi i Brendshëm .....	32
3.9.2	Shërbimet e Informacionit .....	33
4.0	Çështje të tjera .....	33
4.1	Ambasadat dypalëshe .....	33
4.2	Akademia e Diplomacisë .....	35
	Anekse .....	38
	Aneksi A .....	39
	Aneksi B .....	43

## **Shënim**

*Ky raport është një dokument që do t'i nënshtrohet shqyrtimit nga të gjitha palët pjesëmarrëse në këtë projekt dhe si i tillë nuk paraqet opinionet apo konkluzionet tona përfundimtare. Në këtë raport janë përfshirë të gjitha komentet gojore të bëra gjatë diskutimeve me persona të ndryshëm në këtë ministri.*

*Ky raport nuk ka për qëllim të ndryshojë dukshëm angazhimet e shprehura në propozimin tonë: por ky dokument duhet parë si një sqarim i çështjeve të diskutuara në propozim.*

*Qëllimi i projektit është ristrukturimi funksional në atë masë që do të kërkohet. Ky projekt nuk është një iniciativë, e cila synon t'u tregojë nëpunësve të administratës publike se si duhet të kryejnë detyrat e përditshme, apo të bëjë propozime për të përmirësuar performancën e këtyre detyrave nëpërmjet procedurave më efikase dhe përdorimit të teknologjisë së informacionit. Në këtë iniciativë nuk është problem kryesor reduktimi i kostos. Në përfundim, duhet kuptuar që fokusi i projektit është në grupimin funksional e jo procesi i përmbushjes së detyrave, i cili do të kërkonte një shqyrtim më në thellësi të operacioneve specifike. Dihet që një rregullim funksional më efektiv do të çojë edhe në mundësi të uljes së kostos. Megjithatë, nuk është në termat e këtij projekti identifikimi i mënyrave të reduktimit të kostos dhe si të veprohet me to.*

## Fletë përmbledhëse e projektit

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>Shërbime konsulence për përmirësimin e funksioneve publike të institucioneve qendrore</b>
<b>Sponsor:</b>	<b>Banka Botërore</b>
<b>Vendi:</b>	<b>Republika e Shqipërisë</b>
<b>Objektivi i projektit:</b>	<p>Objektivi kryesor i këtij projekti është kryerja e analizës funksionale e organizative të organizmave të administratës qendrore të qeverisë Shqiptare, nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcaktimit të funksioneve kryesore të qeverisë me anë të riformulimit dhe racionalizimit të roleve, misioneve, objektivave strategjikë, funksioneve, strukturave organizative dhe rezultatet e pritshme të institucioneve të sistemit të ministrive;</li> <li>• Identifikimit të funksioneve të tepërta e të mbivendosura në institucionet në shqyrtim e midis tyre dhe identifikimi i atyre njësive të administratës publike që duhen ruajtur, transferuar, deleguar tek organizma të tjerë më të përshtatshëm, eliminuar apo ndarë;</li> <li>• Fuqizimi i kapaciteteve të Departmentit të Administratës Publike për ta aftësuar atë të kryejë analiza funksionale të mëtejshme.</li> </ul>
<b>Qëllimi i projektit:</b>	<b>Grupimi i aktiviteteve aktuale e atyre ekzistuese në funksione të ndara dhe t'i "filtru" ato në funksione potencialisht të tepërta, të transferueshme, racionalizuara apo të privatizueshme në bazë të kriterëve të rëna dakord.</b>
<b>Zonat e ndërhyrjes dhe rezultatet e planifikuara:</b>	<p><b>Ndërgjegjësimi i stafit drejtues për misionin dhe qëllimet strategjike të organizatave të tyre dhe si duhen strukturuar ato për të shërbyer në arritjen e objektivave të tyre.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Struktura më të mëdha menaxhuese.</li> <li>• Kapacitete më të mëdha menaxhuese.</li> <li>• Kredibiliteti i administratës publike më i madh.</li> <li>• Kapacitetet profesionale të stafit të DAP më të rritura.</li> </ul>
<b>Rezultatet e projektit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e situatës së Reformës së Administratës Publike në Shqipëri.</li> <li>• Analiza Funksionale e institucioneve në 17 ministritë ekzistuese.</li> <li>• Raporte që identifikojnë nëse funksionet e njësive nevojiten apo janë të tepërta dhe rekomandimet nëse këto funksione duhen konsoliduar, transferuar, racionalizuar apo privatizuar.</li> </ul>
<b>Aktivitetet e projektit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqyrtimi diagnostik i mjedisit institucional duke u fokusuar në Misionet, objektivat dhe përgjegjësitë funksionale;</li> <li>• Asistencë teknike dhe mbështetje për DAP, për grupet e analizës funksionale në të gjitha ministritë, për vendimmarrësit dhe ekzekutivët e ministrive.</li> <li>• Ndërgjegjësimi i publikut për Reformën në Administratën Publike.</li> <li>• Organizimi dhe menaxhimi i seminareve në vend si dhe udhëtimeve studimore jashtë shtetit.</li> <li>• Nxitja e krijimit të besimit dhe transferimi i shprehive.</li> </ul>
<b>Filimi i projektit:</b>	<b>Shkurt 2005</b>
<b>Zgjatja e projektit:</b>	<b>17 muaj</b>

## **Përmbledhje e propozimeve tona për Ministrinë e Jashtme**

Është e habitshme se si një Ministri relativisht e vogël, siç është Ministria e Punëve të Jashtme, të ketë kaq shumë drejtorë. Për më tepër, hapësira kontrolluese e Sekretarit të Përgjithshëm është kaq e madhe sa e bën punën të pamendueshme. Kjo është e vërtetë edhe sikur të mendojmë që praktikisht, Zëvendës ministrat preferojnë të marrin përsipër një sërë inisiativash për t'i ndjekur personalisht.

Megjithëse, puna kryesore e MPJ lidhet me tre sferat politike, ekonomike dhe të politikës së sigurisë është e drejtë të thuhet që politikëbërja e politikës dhe e sigurisë janë të lidhura ngushtë, veçanërisht kur dihet që integrimi Euro-Atlantik (dmth anëtarësimi në BE dhe NATO) është baza e politikës së jashtme të Shqipërisë. Prandaj do të ishte logjike të shkëputej puna e lidhur drejtpërdrejt me këtë proces integrimi në një Drejtori të Përgjithshme të veçantë.

Brenda fushës së Drejtorisë së Shërbimeve Konsullore dhe Juridike, ka një element të Shërbimeve mbështetëse të Ministrisë (Drejtoria e Protokollit të Shtetit) dhe një element të ofrimit të shërbimeve (vizat dhe pashaportat si dhe legalizimi i dokumentave). Kemi mendimin që njësitë përgjegjëse do të ishte më mirë të grupoheshin sipas funksioneve.

Struktura aktuale e shërbimeve mbështetëse nënkupton që jo më pak se 4 drejtorë dhe një drejtor i përgjithshëm të raportojnë direkt tek Ministri përsa i përket Çështjeve Administrative, Ligjore dhe atyre Konsullore<sup>1</sup>. Kjo strukturë nuk është aspak e përshtatshme për t'u menaxhuar me efektivitet dhe shtron kërkesa të pamundshme për t'u arritur brenda kohës në dispozicion të Ministrit dhe të Sekretarit të Përgjithshëm. Një objektiv i rëndësishëm i kësaj analize do të ishte të racionalizohet dhe thjeshtohet struktura e raportimit si dhe të krijohet një hapësirë e menaxhueshme kontrolli për Sekretarin e Përgjithshëm dhe drejtuesit kryesorë në Ministri.

Propozimet e mëposhtme duhet të merren në konsideratë:

Prioritetet dhe objektivat e ministrisë duhet të bashkohen për të dhënë një grup Objektivash Strategjike, koherente, por të dallueshëm siç jepen në **Aneksin A**:

- 01 Integrimi i Shqipërisë në BE dhe NATO
- 02 Promovimi i stabilitetit dhe sigurisë rajonale në Ballkan dhe shtetet e tjera fqinje
- 03 Zhvillimi i diplomacisë ekonomike dhe kulturore për të arritur begati për Shqipërinë.

---

<sup>1</sup> Zyra e Përfaqësuesit Ligjor mund të shihet si ekuivalent i një Drejtorie në të drejtën e vet.

- 04 Promovimi i marëdhënieve dypalëshe
- 05 Promovimi i diplomacisë shumëpalëshe me pikëpamjen për të rritur rëndësinë politike të Shqipërisë dhe mbështetur iniciativat e projektet që çojnë përpara si shtetin ashtu edhe rajonin.
- 06 Diplomacia Shqiptare do të kërkojë të plotësojë nevojat praktike të Shqiptarëve si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij.
- 07 Struktura e MPJ do të analizohet vazhdimisht për t'u siguruar që përballon sfidat e realiteteve aktuale politike e ekonomike.

### **Propozimet e Strukturës së Ministrisë**

**Rekomandimi 1:** Zyra për Komunikimet, Koordinimin e Përfaqësimit dhe Sekretariati qendror duhet të mbyllet: objektivat që kjo zyrë përpiqet të arrijë duhet të vinë përmes pasjes së një strukture më të thjeshtë dhe më koherente të ministrisë.

**Rekomandimi 2:-** duhet të krijohet një Drejtori e Përgjithshme për Çështjet Politike dhe të Sigurisë (DPÇPS) që të raportojë direkt tek Sekretari i Përgjithshëm. Përgjegjësia kryesore e saj do të jetë të zbatojë Objektivat Strategjikë 1, 2 dhe 4.

**Rekomandimi 3:** Brenda DPÇPS duhet të krijohet një Drejtori e Politikës së Sigurisë. Punonjësit e kësaj drejtorie do të marrin përgjegjësinë për ndjekjen e aktiviteteve të OSBE-së dhe Këshillit të Evropës. Drejtori i Politikës së Sigurisë do të monitorojë CFSP (Politika e përbashkët mbi sigurinë dhe politikën e jashtme e KE-së) dhe CESDP si dhe do të menaxhojë MAP (pra, zyra e NATO-s) si dhe çështje të tjera që lidhen me sigurinë, të tilla si Terrorizmi Ndërkombëtar, Trafikimi i qënieve njerëzore, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, Të drejtat e Njeriut dhe Zbatimi i Ligjit. Përgjegjësia kryesore e DPS do të jetë të zbatohen aspektet e sigurisë së Objektivit Strategjik 1.

**Rekomandimi 4:** duhet të krijohet një Drejtori e Marëdhënieve Dypalëshe (DMD) në varësinë e DPÇPS. Kjo drejtori do të jetë përgjegjëse për mbarëvajtjen e marëdhënieve dypalëshe me shtetet joeuropiane dhe për monitorimin e zhvillimit të marëdhënieve të jashtme të BE-së dhe impaktit të mundshëm mbi objektivat e politikës së jashtme të Shqipërisë.

**Rekomandimi 5:** Duhet të krijohet një drejtori e Çështjeve Europiane (DÇE) në varësi të DPÇPS, një pjesë e punës së Drejtorisë do të ishin iniciativat dypalëshe dhe shumëpalëshe të shteteve të BE-së, shteteve të pranuar dhe Shteteve të tjera Europiane me lidhje të ngushta apo në rritje me BE-në.

**Rekomandimi 6:** Duhet të krijohet një drejtori e Përgjithshme për Çështjet Globale dhe ato Ekonomike (DPÇGE) që të raportojë direkt tek Sekretari i Përgjithshëm. Përgjegjësia kryesore e saj do të jetë zbatimi i Objektivave Strategjikë 3 & 5.

**Rekomandimi 7:** Të krijohet një Drejtori për Çështjet Globale në varësi të DPÇGE për të hartuar politikat dhe të japë rekomandime në lidhje me çështjet

globale që ndikojnë Shqipërinë dhe si duhen menaxhuar këto çështje në baza dypalëshe e shumëpalëshe.

**Rekomandimi 8:** të mbahet Drejtoria për Promovimin Ekonomik dhe Kulturor dhe të vendoset brenda DPÇGE. Ajo duhet të fokusohet në Objektivin Strategjik 3 dhe të ndjekë nga afër zhvillimet dhe politikat e OBT.

**Rekomandimi 9:** në afat të shkurtër, Drejtoria e Shërbimeve të Trupit Diplomatik duhet të vendoset brenda përgjegjësië së Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse. Megjithatë, në mundësinë më të parë, MPJ duhet t'ia japë këtë funksion një ministrie tjetër që ka në përgjegjësinë e vet menaxhimin e pasurisë publike.

**Rekomandimi 10:** si një hap ndërmjetës, Zyra e Përfaqësuesit Ligjor duhet të vendoset brenda përgjegjësisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve Ligjore dhe Politikave Konsullore. Drejtoria e Legjislacionit dhe Traktateve duhet të hiqet e të zëvendësohet me një Drejtori të Çështjeve Ligjore që të mbikëyrë si punën për traktatet ashtu edhe atë ligjore dhe të konflikteve në gjykatat ndërkombëtare. Në një stad të mëvonshëm, përgjegjësia për mbrojtjen/prokurorinë e çështjeve ligjore të qeverisë duhet t'i kalojë organeve të tjera të drejtësisë.

**Rekomandimi 11:** Drejtori i Përgjithshëm i Çështjeve Konsullore dhe Ligjore së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm për Promovimin Ekonomik e Kulturor duhet të krijojnë një Komitet brenda ministrisë për të përcaktuar se cilat kritere duhen përdorur kur zgjidhen Konsujt e ri të nderit, qytetet ku duhen caktuar ata dhe fushën e aktivitetit ekonomik që janë në gjendje të promovojnë më mirë.

**Rekomandimi 12:** duhet caktuar një Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse që të raportojë direkt tek Sekretari i Përgjithshëm. Ai do të menaxhojë të gjitha funksionet administrative të ministrisë. Kjo drejtori duhet të përfshijë dy seksione, një që mbulon shërbimet e “brendshme” si Kontabiliteti, auditimi dhe Burimet Njerëzore dhe tjetra që mbulon shërbimet e “jashtme”<sup>2</sup>, shërbime të cilat përfshijnë Mbështetjen e TI, Blerjet e magazinat si dhe Shërbimet për Trupin Diplomatik.

**Rekomandimi 13:** Auditimet në vend (*in situ*) të ambasadave duhet të kryhen vetëm me aprovimin direkt të Sekretarit të Përgjithshëm kur ka një arsye të mjaftueshme që për shkak të kapaciteteve të lira buxhetore mundësohet abuzimi serioz.

**Rekomandimi 14:** Drejtoria e Shtypit dhe Diplomacisë Publike duhet të mos jetë më. Mbështetja teknike për TI është një funksion mbështetës i korporatës dhe duhet bashkuar me përgjegjësinë e Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse. Të gjitha lidhjet me Shtypin, që përfshijnë edhe dhënien e lajmeve të përditshme për Misionet jashtë shtetit, duhet të jenë përgjegjësi e Koordinatorit të Komunikimit

---

<sup>2</sup> Shërbimet konsiderohen të “jashtme” nëqoftëse stafi që i kryen ato duhet të merret nga jashtë për të ofruar shërbimin, p.sh., blerja e mallrave jashtë ministrisë, riparimi i një ndërtese të zënë nga një ambasadë e huaj.

në Kabinetin e Ministrit dhe nën varësinë e kontrollin direkt të Shefit të Kabinetit apo të një Zëvendës Ministri.

### **Çështje të tjera**

**Rekomandimi 15:** MPJ duhet të adoptojë një sistem formal me pikëzim për ta përdorur në vendimmarrje kur merret në shqyrtim hapja e një ambasade të re dypalëshe.

**Rekomandimi 16:** Akademia e Diplomacisë duhet të mos funksionojë më dhe të zëvendësohet me një Komitet brenda ministrisë mbi zhvillimin e Stafit dhe të drejtohet nga njëri prej zëvendësministrave: ky komitet do të analizojë kërkesat për trajnim të Shërbimit Diplomatik, do të vendosë se cilët diplomatë kërkojnë trajnim të mëtejshëm dhe në çfarë fushash, si dhe do të identifikojë universitetet dhe institucionet trajnuese të Shërbimit Diplomatik (në vend e jashtë tij) të cilët mund të ofrojnë kurse të përshtatshme me kohë të plotë apo të pjesshme.

\* \* \* \* \*

Sa më sipër përmbledh propozimet tona për Ministrinë e Punëve të Jashtme. Për të marrë në konsideratë këto propozime në kontekstin e tyre, duhet t'i referoheni raportit në vijim.

## **1.0 Misioni dhe prioritetet e Ministrisë së Punëve të Jashtme**

Deklarata e Misionit të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) është si më poshtë:

*Ministria e Punëve të Jashtme vepron dhe punon për interesat e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare dhe në të mirë të lirisë, sigurisë dhe mirëqënies së shqiptarëve.*

### **1.1 Prioritetet e Politikës së Jashtme**

Prioritetet e deklaruara të politikës së jashtme (në fillim të vitit 2006) janë si më poshtë<sup>3</sup>:

#### **1. Integrimi shqiptar me BE-në dhe NATO**

MPJ do të angazhojë integrimin e vendit me strukturat Euroatlantike duke mbështetur fuqimisht plotësimin e standardeve të integrimit me anë të proceseve të transformimit politik, ekonomik, social e ushtarak.

#### **2. Mbështetje për zhvillimet rajonale**

MPJ do të synojë sigurinë rajonale, paqen dhe ruajtjen e qetësisë për interesat kombëtare të vendit. MPJ do të rrisë rolin e Shqipërisë në rajon me synimin për të fuqizuar paqen dhe stabilitetin në të dhe arritjen e një marrëveshjeje të drejtë për çështjen e Kosovës, zbatimin e marrëveshjes së Ohrit dhe avancimin e marrëdhënieve diplomatike, politike, ekonomike dhe kulturore me të gjitha vendet në rajon.

#### **3. Zhvillimi i diplomacisë ekonomike e kulturore**

Vendosja e diplomacisë shqiptare në shërbim të ekonomisë së vendit me anë të tërheqjes së investimeve të huaja dhe marketimi i potencialit ekonomik, kulturor dhe të industrisë së turizmit që ofron vendi.

#### **4. Promovimi i marrëdhënieve dypalëshe**

MPJ do të kultivojë marrëdhënie të mira dypalëshe midis shteteve si një bazë për zhvillimet në fusha të ndryshme me përfitim reciprok.

---

<sup>3</sup> Teksti i mëposhtëm në këtë seksion është marrë nga versioni në Anglisht i dokumentit origjinal.

## 5. Promovimi i marëdhënieve shumëpalëshe

MPJ do të rrisë rolin e Shqipërisë në organizatat dhe organet ndërkombëtare, iniciativave shumëpalëshe dhe koalicioneve ndërkombëtare me synimin për të çuar më përpara rolin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, të përmirësojë imazhin e Shqipërisë jashtë dhe ta përfshijë atë në projekte shumëpalëshe që çojnë në stabilitet, paqe dhe siguri në botë.

### **1.2 Objektivat e Politikës së jashtme për 4 vitet e ardhshme**

Me qëllim që të përmbushë misionin dhe të zbatojë prioritetet e saj, MPJ ka përcaktuar një numër objektivash bazë për periudhën 4 vjeçare 2006-2010.:

i. *Politika e jashtme e Shqipërisë gjatë periudhës 4 vjeçare do të çojë përpara procesin e integritit të Shqipërisë në BE dhe NATO.*

Aktiviteti diplomatik do të mbështesë dhe shoqërojë punën e qeverisë në kryerjen e reformave të thella e të plota të cilat i nevojiten këtij integriti. Përmes diplomacisë politike e ushtarake, Shqipëria do të mbështesë fuqimisht procesin e forcimit të aleancave strategjike dhe bashkëpunimit me të gjitha vendet, në kuadër të iniciativave globale mbi sigurinë e njerëzimit dhe zbatimin e reformave në fushën politike dhe atë ushtarake. Për më tepër, për të arritur objektivin e integritit në BE, politika e jashtme shqiptare do të:

- Promovojë bashkëpunimin rajonal, sigurinë dhe begatinë;
  - Mbështesë tregtinë e lirë;
  - Promovojë politikën e zhvillimit rajonal;
  - Eliminonjë krimin e organizuar midis shteteve dhe trafikun e paligjshëm;
  - Të eliminonjë korrupsionin;
  - Të inkurajonjë transparencën e zhvillimeve politike e ekonomike të vendit; dhe
  - Të arrijë progres në çështjet konsullore.
- ii. *Politika e jashtme e Shqipërisë dhe trupi diplomatik do të bëjnë të gjitha përpjekjet për tërheqjen e investimeve të huaja direkte. (IHD).*

Shqipëria beson që afrimi midis popujve e kombeve arrihet fuqimisht me këmbimet ekonomike të rëndësishme e të qëndrueshme. Diplomatët shqiptarë duhet të krijojnë një ndërgjegjësime për klimën tërheqëse që ekziston për bizneset e huaja; kjo do të krijojë mundësitë dhe kushtet e duhura për thithjen e investimeve të huaja dhe një vlerësim më të madh të burimeve natyrore e ekonomike që Shqipëria mund t'i ofrojë investitorëve të huaj potencialë. Për këtë qëllim, politika e jashtme e Shqipërisë do të përdorë diplomacinë ekonomike sa më mirë që është e mundur për të siguruar kontaktet e përditshme të trupit

diplomatik shqiptar me komunitetin e biznesit dhe të investitorëve të juridiksionit ku ato janë akredituar.

iii. *Diplomatët shqiptarë do të intensifikojnë aktivitetin e tyre në arenën shumëpalëshe*

Politika e jashtme shqiptare do të vazhdojë të angazhohet aktivisht në disa organizata të mëdha ndërkombëtare dhe grupe rajonale, p.sh., Kombet e Bashkuara, Këshilli i Europës, OSBE, Koalicioni Antiterror, UNESCO, Frankofonia dhe organizata, konventa, iniciativa, institucione qeveritare e joqeveritare të përfshira në çështjet ekonomike, kulturore, ekologjike, shkencore, juridike dhe të arsimit.

iv. *Politika e jashtme shqiptare do të promovojë diplomacinë kulturore*

Diplomacia kulturore shqiptare do të zhvillohet për të riafirmuar identitetin kombëtar të vendit në lidhje me popujt dhe shtetet e tjerë dhe do të shërbejë për të vënë në pah vlerat e vërteta të kombit, kultivojë një imazh pozitiv për popullin shqiptar dhe në një shkallë më të gjerë të integrojë vendin në proceset e vazhdueshme globale të përhapjes së vlerave kulturore specifike të tij në të gjithë botën. Veçanërisht, diplomacia kulturore duhet të përdoret si një mjet për të promovuar industrinë e turizmit.

v. *Politika e jashtme e Shqipërisë do të promovojë marrëdhëniet dypalëshe, veçanërisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.*

Shqipëria do të intensifikojë marrëdhëniet e saj me të gjitha vendet demokratike: administrata aktuale i konsideron marrëdhëniet me SHBA si prioritet i veçantë dhe me një rëndësi strategjike dhe shumë të madhe për vendin. SHBA konsiderohet si një aleat i pazëvendësueshëm i demokracisë së re shqiptare dhe përveçse do të vazhdojë të jetë një kontribues aktiv në Koalicionin Anti-Terror, qeveria shqiptare do të marrë masa për tërheqjen e investimeve dhe kapitalit amerikan në Shqipëri.

vi. *Politika e jashtme shqiptare do të mbetet e angazhuar me Kosovën.*

Shqipëria do të vazhdojë të luajë një rol aktiv në procesin e marrëveshjes për statusin përfundimtar të Kosovës: MPJ do të përpiqet për arritjen e stabilitetit në rajon, të ruajë paqen dhe sigurinë dhe të vëzhgojë se si zbatohen standardet demokratike dhe si respektohen të drejtat e njeriut në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

vii. *Politika e jashtme shqiptare do të mbështesë fuqimisht marrëveshjen e Ohrit.*

Shqipëria e njeh këtë marrëveshje si platformën e vetme në të cilën mbështeten marrëdhëniet miqësore dhe të fqinjësisë së mirë midis dy vendeve si dhe e ardhmja e Maqedonisë.

viii. *Politika e jashtme shqiptare do të promovojë paqen dhe stabilitetin në Ballkan dhe në rajonin fqinjë.*

Shqipëria do të intensifikojë marrëdhëniet diplomatike, politike, ekonomike dhe kulturore me të gjitha shtetet e Ballkanit. MPJ do të vazhdojë të mbështesë fuqimisht bashkëpunimin rajonal dhe do të mbështetet në kuadrin e plotë të marrëveshjeve të nënshkruar me secilin nga këto vende e të ratifikuara nga parlamenti. Programet praktike dhe realiste të këmbimeve në disa fusha do t'i rrisin këto marrëveshje. Politika e jashtme parashikon një nivel më miqësor të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me Kosovën, Maqedoninë, Kroacinë, Bosnie-Hercegovinën, Serbinë, Malin e Zi dhe shtetet e tjera të Ballkanit. Miqësia tradicionale dhe afatgjatë me Turqinë do të vazhdojë të ushqehet me synimin për të filluar shkëmbime të reja e të frutshme.

ix. *Shqipëria do të promovojë marrëdhëniet me BE-në dhe me Shtetet anëtare mbi baza dypalëshe*

Ndërkohë që si prioritet kryesor ka patur një afrim më të madh me BE-në, diplomacia shqiptare do të intensifikojë marrëdhëniet dypalëshe me secilin nga shtetet anëtare të BE-së dhe në veçanti me anëtarët e tij më të mëdhenj si Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Franca, Italia dhe me shtetet ku ekzistojnë marrëdhënie tradicionale si Austria e Greqia.

x. *Politika e jashtme shqiptare do të kërkojë mbajtjen, rritjen dhe pasurimin e marrëdhënieve me shtetet dhe rajonet me rëndësi të madhe politike.*

Një numër shtetesh e rajonesh kanë një farë peshe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Këta përfshijnë Kinën, Izraelin, Japoninë, Indinë, disa vende të Lindjes së Mesme dhe Kanadanë; në këto vitet e fundit këto shtete kanë dhënë një ndihmë të konsiderueshme e konkrete gjatë periudhës së tranzicionit të vështirë.

xi. *Diplomacia shqiptare do të kërkojë të plotësojë nevojat praktike të shqiptarëve si brenda ashtu edhe jashtë vendit.*

Megjithëse integrimi Euro-Atlantik mbetet qendra e politikës së jashtme shqiptare, MPJ do të luftojë të: plotësojë nevojat e qytetarëve shqiptarë në të gjithë botën, do të punojë për lëvizjen e lirë të qytetarëve të vet; do të hartojë politika e procedura moderne e eficiente konsullore dhe do të promovojë interesat e Diasporës kudo që ata janë në botë.

xii. *MPJ do të reformohet.*


MPJ është përgjegjëse për zbatimin e këtyre objektivave dhe prioriteteve të politikës së jashtme. Prandaj, ajo është e vendosur për të reformuar procedurat dhe mekanizmat e brendshëm si dhe të shqyrtojë metodat e organizimit dhe menaxhimit të saj. Kjo reformë do të bëhet edhe për misionet diplomatike shqiptare jashtë vendit. Organizimi i MPJ është bazuar dhe do të vazhdojë të

bazohet në interesin kombëtar, prioritetet e politikës së jashtme dhe objektiveve të saj afatmesëm e afatgjatë.

\* \* \* \* \*

Përcaktimi i prioriteteve dhe objektiveve të politikës së jashtme të një kombi është një detyrë e pastër politike, dhe prioritetet dhe objektivat duhen pranuar siç janë kur kryhet analiza funksionale e një ministrie tërësisht politike dhe horizontale si MPJ. Megjithatë, paraqitja e misionit të ministrisë si një grup i veçantë i “prioriteteve” dhe “objektiveve bazë” është jo shumë fine dhe tenton të jetë përsëritëse. Sugjerohet që prioritetet dhe objektivat të bashkohen në një grup logjik Objektivash Strategjike, por edhe të dallueshëm nga njëri-tjetri. Këto objektiva (gjithsej 7) rezultojnë nga teksti i mësipërm dhe tregohen në **Aneksin A**; ata do të shërbejnë si një pikë referimi në këtë raport kur të diskutohet struktura e organizatës. .

Tani do të diskutojmë strukturën aktuale të ministrisë, ashtu siç tregohet në faqen e mëposhtme.



**MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS**  
(current structure)

## 2.0 Struktura aktuale e MPJ

Organigrama në faqen e mësipërme tregon strukturën aktuale të MPJ. Këtu dallohen menjëherë dy fakte:

- Ministria ka tre Drejtori të Përgjithshme dhe jo më pak se 16 drejtori, dhe
- 12 zyrtarë të lartë raportojnë drejtpërdrejt tek Sekretari i Përgjithshëm.

Është e habitshme se si një ministri relativisht e vogël si MPJ të ketë kaq shumë drejtorë. Gjithashtu, hapësira kontrolluese e SP është kaq e madhe sa e bën punën të pamenaxhueshme. Kjo është e vërtetë edhe sikur të mendojmë që praktikisht, Zëvendës ministrat preferojnë të marrin përsipër një sërë inisiativash për t'i ndjekur personalisht.

MPJ përbëhet nga 3 tipe të ndryshme Drejtorish të Përgjithshme dhe Drejtorish:

- Drejtoritë Politike, ekonomike dhe të sigurisë
- Drejtoria Juridike e Konsullore
- Drejtoritë Administrative

Më poshtë, do t'i diskutojmë ato shkurtimisht poshtë titujve që reflektojnë marëdhënien e drejtpërdrejtë të varësisë nga SP i ministrisë.

### 2.1 Drejtoria Politike, Ekonomike dhe e Sigurisë

Në strukturën ekzistuese, 6 njësi organizative (të identifikuar si më poshtë) menaxhojnë punën "kryesore" të ministrisë dhe janë përgjegjëse për të zbatuar Objektivat Strategjike 1 deri në 5 siç janë treguar në Aneksin A<sup>4</sup>.

SO 1 Integrimi i Shqipërisë në BE dhe NATO

SO 2 Promovimi i stabilitetit dhe sigurisë rajonale në Ballkan dhe shtetet e tjera fqinje

SO 3 Zhvillimi i diplomacisë ekonomike e kulturore për arritjen e begatisë për shqiptarët

SO 4 Promovimi i Marëdhënieve dypalëshe

SO 5 Promovimi i diplomacisë shumëpalëshe me synimin për të rritur rëndësinë politike të Shqipërisë dhe për të mbështetur projektet dhe iniciativat që çojnë përpara si shtetin ashtu edhe rajonin.

Siç shihet, kjo mbulon të gjithë punën që lidhet me Integrimin Euro-Atlantik, çështjet dy dhe shumëpalëshe, marëdhëniet me vendet fqinje dhe promovimin ekonomik e kulturor.

---

<sup>4</sup> Në këtë raport, Objektivat Strategjike do t'i referohemi si SO 1, SO 2, etj

### 2.1.1 Drejtoria e Përgjithshme e Marëdhënieve Dypalëshe

Drejtoria e Përgjithshme për Marëdhëniet dypalëshe (DPMD)<sup>5</sup> imerret me marëdhëniet e Shqipërisë me vendet e tjera në baza individuale dhe kryesisht përfshihet në zbatimin e SO 4. Gjatë një periudhe njëvjeçare, ka vizita të shpeshta të delegacioneve ministeriale dhe të zyrtarëve të lartë në Shqipëri e jashtë saj: natyrisht, vitet e fundit, ka patur shumë aktivitete të përqëndruara në Marëveshjen e Asocijimit Shqipëri - BE<sup>6</sup>. Kjo drejtori e Përgjithshme (DP) është njësi përgjegjëse për negocijimin, në koordinim me ministritë e tjera të linjës, një shumëllojshmëri marëveshjesh me disa vende në fusha të tilla si Taksimi i Dyfishtë, Imigracioni i paligjshëm, Çështjet detare, garancitë e investimeve, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe pastrimi i parave, etj. Struktura e kësaj drejtorie të Përgjithshme është relativisht e thjeshtë; dy drejtorë, një mbulon Europën, Amerikën e Rusinë dhe tjetri Azinë dhe Afrikën. Që të dy drejtorët raportojnë tek DP. Përveç DP dhe dy drejtorëve, ka 13 nëpunës në këtë DP, megjithëse në kohën kur u bë intervista, nuk ishte ende e qartë se sa nëpunës do të ishin në çdo seksion. Është e arsyeshme të supozojmë gjithashtu që shumica e nëpunësve duhen caktuar në zyrat për Europën dhe Amerikën, ndërsa një numër më i vogël do të caktohet për Azinë, Afrikën, Lindjen e Mesme dhe ish Bashkimin Sovjetik. DPMD është njësi që pritet të punojë më afër me ambasadat dypalëshe jashtë shtetit – në fakt, Drejtori i Përgjithshëm i Marëdhënieve Dypalëshe është personi përgjegjës për t'i dhënë udhëzimet çdo ambasadori në lidhje me çështjet në vazhdim me shtetin e huaj ku është akredituar.

Duke marrë në konsideratë faktin që marëdhëniet me shtetet fqinje i janë caktuar një drejtorie tjetër (Drejtoria e Marëdhënieve me Vendet fqinje – shih më poshtë), misionet me të cilat DPMD pritet të ndërveprojë normalisht janë:

- Europa dhe Rusia: Viena, Brukseli (Misioni në Belgjikë), Kopenhagen, Haga, Budapesti, Berna, Berlina, Londra, Moska, Madridi, Praga, Parisi, Varshava, Sofia, Bukureshti dhe Stokholmi.
- Amerikë: Buenos Aires, Washington dhe Otawa.
- Azia, Lindje e Mesme dhe Afrika: Pekini, Riad, Tokio, Kairo, Tel Aviv dhe Kuala Lumpur.

Mund të shihet, që DPMD duhet të ndërveprojë vazhdimisht me të 26 misionet dhe të paktën teorikisht, duhet të ketë plane veprimi dhe objektiva (afat shkurtër, afatmesme e afatgjatë për secilin nga këto misione: nuk është e nevojshme të themi që duhet të përputhen me objektivat e përgjithshme të MPJ. Drejtori aktual deklaroi që këto objektiva janë dhënë dhe të gjithë ambasadorët e kanë të qartë se cilat janë objektivat e tyre.

---

<sup>5</sup> Në kohën që u zhvillua intervista me DP, kjo drejtori (DPMD) sapo ishte krijuar (5 orë më parë) – prandaj ka të ngjarë të kenë ndodhur ndryshime pas intervistës.

<sup>6</sup> Marëveshjet e Asocijimit me BE-në janë pararendësit e procesit të pranimit të plotë në BE.

### 2.1.2 Drejtoria e Marëdhënieve me Vendet Fqinjë

Drejtoria e Marëdhënieve me vendet fqinje (DMF) mbikqyr marëdhëniet diplomatike me ato vende që janë më afër nga pikëpamja gjeografike (dhe ndoshta më të rëndësishme aktualisht) me Shqipërinë. Kjo drejtori është caktuar të zbatohet SO 2. Drejtoria përfshin 3 seksione të veçanta, Kosovën, Ballkanin Perëndimor; seksioni i Italisë/Greqisë/Turqisë drejtohet nga një shef seksioni dhe nëpunës. Ballkani Perëndimor është termi që përdoret nga Bashkimi Europian për nën-rajonin që përfshin Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Kroacinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbinë e Malin e Zi. Kosova, e administruar nga KB, teknikisht është një provincë e Serbisë, por Shqipëria i konsideron marëdhëniet me këtë territor të jenë në baza dypalëshe shtet me shtet. Me përjashtim të Shqipërisë, vendet e Ballkanit Perëndimor më parë ishin republika përbërëse të Republikës Federale të Jugosllavisë. Italia, Greqia dhe Turqia konsiderohen me një rëndësi të veçantë për Shqipërinë – ka një numër lidhjesh afatgjata historike, etnike, kulturore e ekonomike me këto shtete. Ashtu si në rastin e DPMD, kjo drejtori duhet të ndërveprojë me një numër misionesh shqiptare jashtë; këto përfshijnë Romën (përfshi Selinë e Shenjtë), Athinën, Ankaranë, Prishtinën (Kosovë), Zagrebin, Beogradin dhe Shkupin.

Drejtori i përshkroi marëdhëniet me këto vende si “të ndjeshme e delikate”. Ato përcaktohen nga kufijtë e përbashkët, interesat e përbashkëta dhe të kundërta, nga problemi i diasporës shqiptare<sup>7</sup>. MPJ bën një dallim të kujdesshëm midis atyre shqiptarëve që jetojnë në zonat ku janë vendosur për disa breza me radhë (Maqedonia Perëndimore është një shembull i tillë) dhe atyre që kanë emigruar vitet e fundit (p.sh., në Itali dhe SHBA). DMF merret ekskluzivisht me çështjet që dalin nga grupi i parë, që do të thotë me shqiptarët etnikë që jetojnë relativisht pranë territorit aktual të Shqipërisë.

### 2.1.3 Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Shumëpalëshe

Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Shumëpalëshe (DPÇSh) merret me bashkëveprimin e Shqipërisë me një sërë organizatash shumëpalëshe si Kombet e Bashkuara, Këshilli i Evropës, etj. Struktura e DP përmblodh dy sektorë të veçantë, Drejtoria e Marëdhënieve Ndërkombëtare dhe Drejtoria e Iniciativave Rajonale.

Drejtoria e Marëdhënieve Ndërkombëtare (**DMN**) është e ndarë në dy seksione, një që merret me Kombet e Bashkuara dhe një tjetër me OSBE dhe me Këshillin e Evropës. Seksioni i parë ka një shef seksioni dhe dy specialistë, ndërsa seksioni i dytë ka një shef seksioni dhe tre specialistë.

---

<sup>7</sup> Përpara se Maqedonia të bëhej pjesë e Jugosllavisë në vitin 1944, Maqedonia Perëndimore ishte pjesë e Shqipërisë. Në këtë zonë, shqiptarët janë banorët origjinalë. Shqiptarët janë grupi i dytë për nga numri i popullsisë në Maqedoni pas Maqedonasve Sllavë. Në varësi të burimit ku merren të dhënat, në Maqedoni jetojnë afërsisht 700,000 deri në 800,000 shqiptarë etnikë.

Drejtoria e Iniciativave Rajonale (DIR) fokusohet në ato organizma dhe struktura shumëpalëshe që ndikojnë Ballkanin Perëndimor dhe vendet gjeografikisht më afër Shqipërisë. Më të rëndësishmit këtu janë:

- Pakti i Stabilitetit (**SP**)
- Iniciativa e Europës Qendrore (**CEI**)
- Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (**BSEC**)
- Procesi i Bashkëpunimit të Europës Juglindore (**SEECP**)
- Iniciativa Adriatik – Jon (**AII**)

Në Aneksin B jepen disa informacione për këto organizime. Kjo drejtori më parë ka patur 6 punonjës, por ky numër është reduktuar tek Drejtori dhe tre punonjës: kjo kundërshton udhëzimet e Departamentit të Administratës Publike (**DAP**) në lidhje me strukturat e drejtorive të cilat duhet të kenë në varësi 2 ose më shumë seksione.

Kjo Drejtori e Përgjithshme pritet që të bashkëpunojë kryesisht me Misionet shumëpalëshe të Shqipërisë jashtë shtetit. Këto janë:

- Misioni i Përhershëm pranë Këshillit të Europës, Strasburg
- Misioni i Përhershëm pranë Kombeve të Bashkuara, New York
- Misioni i Përhershëm pranë UNESCO-s, Paris
- Misioni i Përhershëm pranë UNOG<sup>8</sup>, Gjenevë
- Misioni i Përhershëm pranë UNOV<sup>9</sup>, OSBE etj, Vienë

#### **2.1.4 Drejtoria e NATO-s**

Drejtoria e NATO-s (Drejtori plus tre specialistë) merret kryesisht me elementët politikë të Planit të Veprimit të Anëtarësisë në NATO (**MAP**) e si i tillë është përgjegjës për aspektet e zbatimit të SO 1 – përveç seksionit brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve Shumëpalëshe që merret me OSBE, kjo drejtori merret kryesisht me Çështjet e sigurisë. Përsëri këtu vërejmë që struktura e kësaj drejtorie nuk përmbush udhëzimet e DAP-it.

NATO filloi MAP në prill të vitit 1999, me synimin për të mbajtur të hapur derën e aleancës për anëtarët e ardhshëm. MAP konsiston në programe të hartuara për secilin vend me aktivitete dhe shkëmbime për të ndihmuar vendet aspirante për t'u përgatitur për anëtarësim të mundshëm. MAP përmban 5 “kapituj”:

- Çështjet politike e ekonomike;
- Çështjet e mbrojtjes/ushtarake;

---

<sup>8</sup> Zyra e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë

<sup>9</sup> Zyra e Kombeve të Bashkuara në Vienë

- Çështjet e burimeve;
- Çështjet e sigurisë, dhe
- Çështjet ligjore.

Secili vend i MAP përgatit një plan vjetor të detajuar si pjesë e MAP-it, me aktivitetet për të përmbushur objektivat në të pesë “kapitujt”. Mekanizmi i MAP ka plotësuar një program ekzistues bashkëpunimi midis vendeve kandidate dhe NATO-s nën patronazhin e Procesit të NATO-s për Partneritetin për Paqe (ose **PfP**) Planifikim dhe Shqyrtim (ose **PARP**). Në formën e tij aktuale, PARP konsiston në një sërë objektivash ndër funksionues dhe në forcat e mjetet. Mekanizmat e tjerë dypalësh midis vendeve kandidate dhe vendeve kryesore të NATO-s shërbejnë për të dhënë udhëzime të mëtejshme. Aspektet më sfiduese që përballojnë kandidatët janë ato në sferën ushtarake. Kandidatët duhet të:

- Japin forca e mjete për misionet e NATO-s;
- Marrin pjesë në strukturën ushtarake të NATO-s, agjencive dhe planifikimit, dhe
- Të ndjekin standardizimin dhe ndërveprimin.

Arritja e sa më sipër nënkupton pasjen e kapacitetit dhe vullnetit politik për të qenë anëtarë aktivë të NATO-s dhe t'i kushtohen burime të mjaftueshme për këto përpjekje, të cilat në vetvete, kërkojnë ekzistencën e mekanizmave të përshtatshëm të planifikimit të burimeve të mbrojtjes.

Drejtoria e NATO-s punon ngushtësisht me Ministrinë e Mbrojtjes në punën për MAP dhe merret kryesisht me çështjet politike e ligjore. Drejtoria së bashku me Përfaqësinë e Përhershme të NATO-s (në Bruksel) është e përfshirë ngushtësisht me përfaqësimin diplomatik të progresit të vendit në lidhje me MAP. Kjo punë diplomatike kryhet duke përdorur një qasje “dypalëshe” (Shqipëria lidhet me NATO-n) dhe brenda kuadrit të Kartës së Adriatikut<sup>10</sup>.

### 2.1.5 Drejtoria për Promovimin Ekonomik e Kulturor

Drejtoria e krijuar rishtasi për Promovimin Ekonomik e Kulturor është përgjegjëse për zbatimin e SO 3. Drejtorja aktuale (e rekrutuar nga jashtë shërbimit diplomatik) pohon që në drejtorinë e saj janë caktuar 4 specialistë, dy do të

<sup>10</sup> Karta e Adriatikut (shtetet që e kanë nënshkruar: SHBA, Shqipëria, Kroacia dhe Ish Rep. Jugosllave e Maqedonisë) përforcon mbështetjen e vazhdueshme të SHBA për Procesin “Dera e Hapur” të NATO-s, duke nënvizuar synimin e Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë për integrim të plotë në NATO dhe institucionet e tjera Euro-Atlantike. Neni 36 i Kartës thekson që: “Në mënyrë që të forcohen këto lidhje, Partnerët kanë planifikuar të krijojnë një “Komision Partneriteti”....Partnerët pranojnë që ky Komision do të mblidhet dy herë në vit apo më shpesh, sipas nevojës, për të vlerësuar rezultatet e konsultimeve dypalëshe mbi reformën demokratike, të drejtat e njeriut, reformën ekonomike, krimin dhe korrupsionin, sigurinë rajonale dhe fushat e tjera, dhe për të analizuar progresin e arritur në lidhje me plotësimin e objektivave të kësaj Karte. ...”

merren me Promovimin Ekonomik, dhe dy do të fokusohen në atë kulturor; por, në kohën kur është kryer intervista, ajo nuk ishte e qartë se çfarë buxheti operues do të kishte në dispozicion. Në lidhje me Promovimin Ekonomik, prioritetet fillestare që paraqiti Drejtoresha janë:

- Hidrocentralet e vegjël
- Mundësitë që dalin nga procesi i privatizimit
- Tekstilet dhe veshjet
- Produktet bujqësore

Është bërë pak punë në lidhje me Promovimin Kulturor, megjithatë shihet një lloj interesi për të shfrytëzuar artizanatin shqiptar.

### **2.1.6 Drejtoria e Bashkimit European**

Drejtorja e Bashkimit European, përveç drejtores të drejtorisë ka edhe dy specialistë. Duke patur parasysh që Marëveshja e Stabilizim Asocijimit Shqipëri – BE është përfunduar, nuk është e qartë se cila do të jetë e ardhmja e kësaj drejtorie. Shumica e punës për integrimin e institucioneve Shqiptare me ato të BE-së i është caktuar Ministrisë së Integritimit si dhe ministrive të linjës. Përtej zhvillimeve të monitorimit brenda BE-së, do të dukej sikur kjo drejtori nuk ka fushë të qartë përgjegjësish përveç kontributit shumë të kufizuar në aspekte të SO 1.

\* \* \* \* \*

Megjithëse, puna kryesore e MPJ përqëndrohet në tre sfera kryesore të politikës, ekonomisë dhe politikës së sigurisë, duhet pranuar që politika dhe politikat mbi sigurinë janë shumë pranë njera-tjetrës, veçanërisht duke ditur që Integrimi Euro-Atlantik është guri themeltar i politikës së jashtme të Shqipërisë (dmth anëtarësimi në NATO dhe në BE). Prandaj do të ishte logjike të ndahej puna që lidhet direkt me këtë proces në një drejtori të përgjithshme të veçantë.

## **2.2 Drejtoria Konsullore dhe Juridike**

Drejtorja Konsullore (dhe Protokolli) zbatojnë kryesisht konventën e Vienës hartuar në 1963 dhe e cila u adoptua në të gjithë botën nga të gjitha shtetet e pavarura. Konventa fokusohet në privilegjet, imunitetet dhe marrëdhëniet konsullore. Drejtoritë ligjore zbatojnë ligjet e traktatet ndërkombëtare dhe mbrojnë qeverinë në gjyqet ndërkombëtare në rastet kur qeveria është palë në gjyq.

### **2.2.1 Drejtoria e Protokollit të shtetit**

Kjo drejtori ka dy seksione: një që merret me Protokollin e Shtetit dhe tjetra me Shërbimet për Diplomatët e Huaj. Seksioni i parë (me katër punonjës) merret

kryesisht me organizimin e vizitave në Tiranë nga personalitetet e huaja. Detyrat e nëpunësve të këtyre seksioneve përfshijnë:

- Përgatitjen e pritjes së personave VIP (pritja e përcjellja në aeroport e diplomatëve apo personaliteteve që vizitojnë vendin dhe shoqërimi i tyre në institucionet qendrore). Kjo nënkupton që nëpunësit e kësaj zyre duhet të jenë disponibël 24 orë në ditë, 7 ditë në javë;
- Caktimi i takimeve dhe të gjitha aktiviteteve të tjera për vizitat zyrtare e shtetërore;
- Sigurimi i transportit të përshtatshëm dhe bërja e planeve të përshtatshme logjistike;
- Përgatitja e programeve zyrtare të vizitave;
- Drejtimi i detyrave dhe përcaktimi i planeve për festimet e festës kombëtare, dhe ceremonive të tjera zyrtare;
- Përgatitja e programeve të prezantimit të kredencialeve tek Presidenti i Republikës nga ambasadorët e sapo emëruar të akredituar në Tiranë si dhe programet e vizitave të largimit nga ambasadorët që përfundojnë periudhën e qëndrimit të tyre.
- Përballimi dhe zbutja me takt e vështirësive të papritura (ose të parashikuara) që mund të krijohen gjatë vizitave zyrtare;
- Mbajtja e kontakteve të përditësuara të zyrtarëve në Ministrinë e institucionet qendrore, veçanërisht të atyre që merren me imigracionin, Aviacionin Civil, Policinë, etj;
- Organizimi i fotografimeve të rastit si dhe të konferencave të shtypit;
- Shtypja e Letër kredencialeve (të cilat duhen firmosur nga Ministri i jashtëm dhe Presidenti i Republikës) për Konsujt e Nderit/të Përgjithshëm të sapo emëruar si dhe Ambasadorët që përfaqësojnë Shqipërinë jashtë shtetit;
- Mbështetja e organizimit të Konferencave Ndërkombëtare të organizuara nga qeveria shqiptare;
- Këshillimi për procedurat e duhura protokollare për misionet shqiptare jashtë vendit dhe ministrinë në Tiranë;
- Mbajtja e një liste të përditësuar të stafit të huaj diplomatik në Shqipëri (“lista diplomatike”) dhe mbajtja e saj në formë të printuar dhe në faqen në internet të MPJ.

Seksioni i Protokollit të Shtetit (i njohur gjithashtu si Seksioni i Ceremonive) përdor rreth 7 autovetura tip Benz Mercedes të zotëruara nga shteti (nga 20 në dispozicion) për të bërë transportin zyrtar të personaliteteve të huaja: një nga punonjësit është fotograf, i cili udhëton shpesh jashtë në rastet kur Ministri i Jashtëm bën vizita zyrtare jashtë vendit.

Seksioni i Shërbimeve Diplomatike me 3 punonjës i shërben nevojave të diplomatëve të huaj në lidhje me dispozitat e Konventës së Vienës. Detyrat më të zakonshme janë:

- Kontrolli dhe pritja e të drejtave “duty free” (ngarkesa diplomatike, sende personale, verëra dhe pije alkoolike e mallra të tjerë) të importuara nga ambasadat rezidente;
- Lëshimi i kartave të identitetit për diplomatët e huaj;
- Organizimi dhe bërja e targave të makinave CD që i takojnë stafit të ambasadës së huaj;
- Përpunimi i shkeljeve të trafikut, lejeve të punës (në rast se kërkohen) dhe të gjitha lejeve të tjera, licensave, përjashtimeve nga taksat dhe dokumentave që mund të kërkojnë diplomatët e huaj gjatë qëndrimit të tyre në Tiranë.

### **2.2.2 Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Ligjore dhe Politikave Konsullore**

Kjo Drejtoria e Përgjithshme ka dy drejtori: Drejtorinë e Ligjeve e Traktave dhe Drejtorinë Konsullore.

Drejtoria e Ligjeve e Traktateve (Drejtori dhe tre juristë) fokusohet kryesisht në ato Traktate e Konventa ndërkombëtare, të cilat ka nënshkruar Shqipëria apo edhe ato të cilat po i shqyrton për t'i nënshkruar apo jo. Një shembull i tillë është Konventa e Hagës. Vendet që nënshkruajnë konventën e Hagës bien dakord të ndjekin një sërë rregullash në lidhje me jurisdiksonin e konflikteve midis shteteve me kufij të përbashkët. Përfshihen pothuajse të gjitha konfliktet civile e tregtare.

Meqënëse ndiqen këto rregulla ligjore, çdo vend bie dakord për të zbatuar pothuajse të gjitha gjykimet e vendeve anëtare dhe urdhërat e gjykatave, që i nënshtrohen vetëm një përjashtimi të vogël për ato gjykime që “janë haptazi të papajtueshme me politikën publike” apo për përjashtimet specifike të traktatit. Një gjykim në një vend është i detyrueshëm në të gjitha vendet anëtare të Konventës së Hagës edhe kur vendi nuk ka ndonjë lidhje me konfliktin përkatës. Nuk ka ndonjë kërkesë për harmonizimin e ligjeve ndërkombëtare për ndonjë çështje dhe nuk ka kufizime për tipet e ligjeve ndërkombëtare që duhen zbatuar.

Konventa mbulon një sërë fushash dhe është një dokument zhvillimi: ajo mbulon fusha shumë të ndryshme si: Rrëmbimi fëmijëve, Pronësia Intelektuale dhe Mbrojtja e Pasurisë Kulturore në kohë lufte etj. Drejtoria e Legjislacionit e Traktateve duhet të monitorojë vazhdimisht zhvillimet dhe ndryshimet që bëhen, dhe të lidhet shpesh me Minsitrinë e Drejtësisë. Ka gjithashtu shumë traktate të tjera ndërkombëtare mbi një shumëllojshmëri çështjesh si kundër terrorizmit, pastrimi i parave, armët kimike, etj.

(Struktura aktuale e MPJ përfshin gjithashtu edhe një Zyrë të Përfaqësimit Ligjor që raporton direkt tek Ministri i Punëve të Jashtme e si e tillë nuk është pjesë e

kësaj Drejtorie të Përgjithshme: qëllimi i kësaj zyre është të përfaqësojë ministrinë në rastet e gjyqeve ndërkombëtare kur më shpesh qeveria është në pozicionin e të akuzuarit. Megjithëse në këtë zyrë punojnë juristë, puna e saj është krejt e ndryshme nga Drejtoria e Ligjeve e Traktateve e megjithatë duke patur një formim ligjor shpesh mund të ketë edhe mbivendosje).

Drejtoria Konsullore merret me legalizimin e dokumentave, përpunimin e aplikimeve për vizë të dorëzuar nga të huajt në misionet shqiptare jashtë shtetit si dhe me aspekte të ndryshme të politikës konsullore.

Seksioni i legalizimeve ndodhet në një ndërtesë të veçantë në Tiranë, në të cilën publiku mund të drejtohet më lehtë. Kjo zyrë përbëhet nga 2 punonjës të ministrisë, njëri nga të cilët është shefi i zyrës dhe 3 persona të kontraktuar. 'Legalizimi' është një formalitet i kërkuar nga legjislacioni i disa vendeve, para se këto dokumenta të pranohen si të vërteta e origjinale në jurisdiksonet e tyre. Konventa e Hagës nuk kërkon legalizim për vendet që e kanë firmosur atë, përfshi edhe disa vende jashtë Europës dhe ka të bëjë me zëvendësimin e një vule të vetme (apo 'apostille') e lëshuar nga një autoritetet: në rastin e Shqipërisë kjo është Ministria e Punëve të Jashtme. Dokumentat për të cilat zbatohet konventa janë "dokumenta publike", të cilat përcaktohen si:

- Dokumenta gjykatë;
- Dokumenta administrative, pra nga gjykatat;
- Aktet noteriale;
- Çertifikatat zyrtare për individët privatë, p.sh., protokollimi i regjistrimit të një dokumenti apo të faktit të ekzistencës së tij në një datë të caktuar, dhe
- Autenticiteti i firmave zyrtare dhe të noterëve.

Ky seksion punon me një efikasitet të lartë, duke përpunuar 1500 deri në 2000 dokumenta në ditë: Drejtori i Buxhetit e Financës në ministri parashikon një të ardhur neto për vitin 2006 prej rreth 20 milion lek. Shërbimet e këtij seksioni janë shumë të kërkuara, sepse shqiptarët kërkojnë legalizimin e disa dokumentave kur përpunohen vizat, lejet e punës për jashtë shtetit, udhëtimet për punë jashtë shtetit, aplikimet për universitetet e huaja, etj.

Seksioni i Vizave e Pashaportave (tre punonjës përfshirë edhe shefin e seksionit) përpunon deri në 10,000 aplikime për viza në vit. Puna kërkon bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Brendshme dhe ka (në shumicën e rasteve) autoritetin përfundimtar se kujt i duhet dhënë apo jo viza.

Seksioni që merret me Politikën Konsullore fokusohet në një sërë çështjesh që përfshijnë:

- Caktimin e Konsujve të Nderit jashtë shtetit dhe mbështetja e tyre në mënyra të ndryshme gjatë gjithë periudhës së caktuar për ta;
- Mbështetje për qytetarët shqiptarë që përfshin:

- Rastet e ekstradimit në dhe nga Shqipëria;
- Transferimi i të burgosurve, veçanërisht shqiptarët nga qendrat e huaja të burgimit;
- Shqiptarët e burgosur në qendrat e huaja të burgimit;
- Ndjekja për t'i gjetur e personave të humbur në Shqipëri dhe jashtë saj;
- Paratë e vjedhura nga udhëtarët shqiptarë;
- Kërkesat për informacion nga Ambasadat shqiptare jashtë shtetit dhe trajtimi i çështjeve të ndryshme që dalin. Drejtorja e Protokollit apo drejtori të tjera të MPJ mund të përballojnë disa nga kërkesat, por të tjerat i kalohen ministrive të tjera;
- Kërkesat e ndryshme për informacion nga publiku veçanërisht në lidhje me kërkesat për viza në dhe nga vende të ndryshme.

\* \* \* \* \*

Brenda fushës së Drejtorive Konsullore dhe Ligjore ka një element të shërbimeve mbështetëse (që është Drejtorja e Protokollit të Shtetit) dhe një element i ofrimit të shërbimeve (vizat dhe pashaportat dhe dokumentat e tjera të noterizuara). Besojmë që njësitë përgjegjëse duhet të grupohen sipas funksioneve të tyre.

## **2.3 Drejtoritë administrative**

Këto drejtori administrative japin më shumë shërbime mbështetëse për drejtoritë kryesore të ministrisë dhe shërbime për publikun e gjerë dhe diplomatët e huaj; ato shumë rrallë (ose aspak) përfshihen në çështje politike dhe të tregtisë me jashtë. Një përjashtim nga kjo, është rasti i punës ligjore të kryer nga juristët e punësuar në ministri veçanërisht në situatat kur Qeveria shqiptare negocion një pozicion në lidhje me hartimin e një traktati ndërkombëtar.

Në përgjithësi, këto drejtori janë të njëjta për të gjitha ministrinë dhe mbulojnë funksionet bazë mbështetëse si Kontabiliteti & Buxheti; magazinat dhe Blerjet; Burimet Njerëzore, Auditimi i brendshëm; Protokolli dhe arshiva. Një shikim në organigramën aktuale tregon që përgjegjësia për këto funksione ndahet midis 5 drejtorëve, 4 nga të cilët raportojnë drejtpërdrejt tek Sekretari i përgjithshëm (tjetri raporton tek ministri). Ky lloj organizimi rrit në mënyrë të panevojshme hapësirën menaxhuese të Sekretarit të Përgjithshëm.

### **2.3.1 Drejtorja e Buxhetit, financës & Shërbimeve**

Përveç drejtorit, kjo drejtori ka pesë punonjës, një nga të cilët është Shef Seksioni apo Asistent i Parë<sup>11</sup>.

---

<sup>11</sup> Në këtë raport, termi shqip 'Shef sektori' është zëvendësuar me Shef Seksioni

Funksionet e kësaj drejtorie janë të:

- Përgatisë vlerësimet vjetore financiare të ministrisë për vitin e ardhshëm.
- Kryejë të gjitha transaksionet financiare në emër të ministrisë;
- Sigurojë që regjistrimet e inventarit të ministrisë përditësohen
- Sigurohen shërbimet për blerjet për stafin e ministrisë,
- Mbajtja e regjistrimeve të sakta financiare
- Mbikqyrja e llogarive dhe shpenzimeve të Ambasadave

### **2.3.2 Drejtoria e Auditimit të brendshëm dhe Inspektimit**

Drejtori, së bashku me dy punonjës të tjerë (jo diplomatë) është përgjegjës për auditimin e brendshëm të llogarive të MPJ dhe të atyre të Ambasadave jashtë vendit. Kjo drejtori është e njëjtë në të gjitha ministritë e tjera, krijimi i saj është i përcaktuar në ligj. Pjesa më e madhe e punës së kësaj drejtorie është e përqëndruar në transaksionet financiare të bëra nga Misionet jashtë shtetit dhe është e vështirë t'i shpëtosh përshtypjes që brenda drejtorisë ekziston një klimë e përgjithshme dyshimi përse i përket shpenzimeve të bëra nga stafi diplomatik i caktuar jashtë shtetit. Në të vërtetë personeli i kësaj drejtorie e vlerëson të domosdoshëm udhëtimin e qëndrimin disa ditë në të paktën 3 ambasada në vit për të ekzaminuar në vend regjistrimet e shpenzimeve. Është e vështirë të jepet vlera mesatare vjetore totale dhe numri i parregullsive financiare i raportuar nga kjo drejtori, por mendohet që vlera prej €30,000 është një shifër mesatare për një vit të caktuar, nga e cila pjesa më e madhe e parregullsive supozohet që kryhen nga misionet e huaja. Të gjitha auditimet kryesisht përqëndrohen në raportimin financiar, por në të ardhmen e afërt ka plane për të futur edhe auditimet e performancës. Por, nuk është e qartë se mbi cilën bazë do të matet performanca.

### **2.3.3 Drejtoria e Personelit dhe Arkivës**

Në kohën që u kryen intervistat, drejtori sapo ishte emëruar dhe vetë drejtoria nuk ishte ndërtuar ende. Megjithatë, 7 nëpunës i raportojnë drejtorit, një nga të cilët do të caktohet si arkivist. Kjo drejtori mban regjistrimet e BNj për dosjet e personelit, lejet e zakonshme dhe regjistrimet për mungesa me raport nga mjeku, etj.

### **2.3.4 Drejtoria e Shtypit dhe Diplomacisë Publike**

Kjo drejtori ka dy seksione të veçantë (secili i drejtuar nga një shef seksioni) që kryejnë funksione shumë të ndryshme: Seksioni i Teknologjisë së Informacionit dhe ai i Shtypit & Informacionit.

Seksioni i IT ka dy punonjës që japin asistencë teknike për të gjithë ministrinë: ata mirëmbajnë infrastrukturën e IT të ministrisë dhe zgjidhin çdo problem që stafi i ministrisë mund të ketë me pajisjet kompjuterike apo programet. Ato

mirëmbajnë gjithashtu edhe faqen e internetit të ministrisë dhe sigurojnë që ajo është e përditësuar.

Seksioni i Shtypit e Informacionit ka 4 specialistë që kanë tre funksione kryesore në mënyrë që:

- Të mbajë ministrin, stafin e ministrisë dhe diplomatët shqiptarë të informuar për zhvillimet politike, legjislative dhe ekonomike në Shqipëri;
- Të mbajë publikun shqiptar të informuar për punën e MPJ – kjo nënkupton organizimin e konferencave për shtyp, dhe të
- Bashkëpunojë me median e huaj për të pasqyruar një imazh pozitiv të Shqipërisë në të gjithë botën.

Anëtarët e stafit të seksionit lexojnë gazetatat e përditshme për lajme dhe shpërndajnë raporte në rrugë elektronike në rrjetin e ambasadave dhe stafin e ministrisë. Ato grumbullojnë informacion edhe nga Agjencia Telegrafike Shqiptare, shërbim për të cilin ministria paguan. Një ndër prioritetet e drejtorit është të sigurojë që ambasadorët marrin një version të saktë të lajmeve kundrejt version të shtrembëruar politikisht që mund të ofrojnë disa gazeta vendase.

### **2.3.5 Drejtoria e Shërbimeve të Trupit Diplomatik**

Kjo drejtori funksionon në mënyrë të pavarur nga pjesa tjetër e ministrisë. Përgjithësisht, ajo është përgjegjëse për menaxhimin e pasurisë shtetërore të zënë nga ambasadat e huaja. Në regjimin e mëparshëm komunist, drejtoria ka patur më shumë funksione, që përfshinin furnizimin e stafit të ambasadave më sende që nuk mund të gjendeshin lehtë nga ta. Drejtoria ishte shumë më e madhe, por tani është zvogëluar deri në 19 persona. Struktura aktuale tregon që Drejtori raporton tek Ministri i Punëve të Jashtme. Këtë e gjykojmë si një marrëdhënie të papërshtatshme raportimi dhe që nënkupton që Ministri të përfshihet në një shërbim të pastër administrativ mbështetës.

\* \* \* \* \*

Struktura aktuale nënkupton që jo më pak se 4 drejtorë dhe një Drejtor i Përgjithshëm të raportojnë direkt tek Sekretari i Përgjithshëm dhe 2 drejtorë raportojnë direkt tek ministri përsa i përket çështjeve administrative, ligjore e konsullore.<sup>12</sup> Kjo strukturë nuk është e mirë për t'u menaxhuar efektivisht dhe shtron kërkesa të përealizueshme për kohën e Ministrit dhe të Sekretarit të Përgjithshëm. Një objektiv i rëndësishëm për këtë analizë do të ishte të riorganizohet dhe thjeshtohet struktura raportuese dhe të krijohet një hapësirë e menaxhueshme kontrolli për Sekretarin e Përgjithshëm dhe zyrtarët e tjerë të lartë të ministrisë.

---

<sup>12</sup> Zyra e Përfaqësimit Ligjor mund të shihet si ekuivalente me një Drejtori.

### **2.3.6 Zyra për Ndërkomunikimin, Koordinimin e Përfaqësimit dhe Sekretariatit Qendror**

Emri i kësaj zyre të lë të mendosh që ekziston një lloj shqetësimi brenda MPJ që komunikimi i brendshëm dhe koordinimi midis drejtorive të ndryshme mund të ishte një problem i vazhdueshëm. Duke patur parasysh që struktura aktuale përbëhet nga shumë drejtori të Përgjithshme dhe drejtori që raportojnë direkt dhe në mënyrë të pavarur tek Sekretari i Përgjithshëm, kjo gjë nuk të habit: shqetësimi është plotësisht i justifikueshëm. Por, megjithatë, në vend të krijimit të një strukture të fragmentuar dhe përpjekjes për ta “ngjitur” atë tek pjesa tjetër, do të ishte më efektive të krijohet një strukturë logjike, e thjeshtë dhe efektive, e cila do të mundësonte që Sekretari i Përgjithshëm të sigurohet që MPJ i realizon marëdhëniet me jashtë për Qeverinë e Shqipërisë në një mënyrë më koherente dhe efektive.

**Rekomandimi 1:** Zyra për Ndërkomunikimin, koordinimin e Përfaqësimit dhe Sekretariatit qendror duhet të mos ekzistojë më: objektivat që kjo zyrë përpiqet të arrijë duhet të bëhen nëpërmjet zbatimit të një strukture më të thjeshtë dhe më koherente të Ministrisë.

### 3.0 Ristrukturimi i Ministrisë për përmirësimin e funksionalitet të saj

#### 3.1 Çështje të sigurisë

Kur marrim në konsideratë sigurinë kombëtare, një anëtarësim potencial në një aleancë tërësisht ushtarake si NATO nuk është e vetmja çështje për t'u marrë në shqyrtim. Konsiderata të tjera të rëndësishme përfshijnë terrorizmin ndërkombëtar, përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë; imigracioni i paligjshëm, abuzimet me të drejtat e njeriut<sup>13</sup>; dhe, Zbatimi i Ligjit. Të gjitha këto çështje nuk kërkojnë vetëm që forcat e armatosura kombëtare dhe policia e çdo shteti të jetë mjaft e trajnuar dhe pajisur për të përballuar këto sfida, por gjithashtu, duke patur parasysh që këto fenomene po rriten në nivel ndërkombëtar, mekanizmat dhe marëveshjet ndërkufitare duhet të jenë të krijuara në mënyrë që të kontrollojnë, monitorojnë dhe veprojnë me efektivitet për të kapërcyer këto probleme. Prandaj, është menduar që MPJ të ketë një Drejtori të fokusuar specifikisht në Politikën e Sigurisë: kjo drejtori nuk do të jetë përgjegjëse vetëm për menaxhimin e MAP në lidhje me anëtarësimin në NATO, por gjithashtu duhet të ketë një pamje të përgjithshme të çështjeve të sigurisë në përgjithësi, që përfshijnë edhe konsideratat e identifikuara më lart.

Dy organizata të rëndësishme aktive në fushën e sigurisë janë Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (**OSBE**) dhe Këshilli i Europës; të dyja këto organizata aktualisht janë nën përgjegjësinë e DPMSH. OSBE është organizata më e madhe në botë për sigurinë rajonale. Ajo përfshin 55 shtete nga Europa, Azia Qendrore dhe Amerika dhe ofron një forum për negociata politike dhe vendimmarrje në fushat e paralajmërimit në kohë, parandalimit të konfliktit, menaxhimit të krizës dhe rehabilitimit pas konfliktit. Çështjet në vijim (midis të tjerave) konsiderohen si çështje të rëndësishme që lidhen me sigurinë: Trafikimi i qenieve njerëzore, Kontrolli i armëve, Kontrolli i kufirit; demokratizimi, të drejtat e minoriteteve, toleranca dhe mosdiskriminimi, Zbatimi i ligjit; të drejtat e njeriut; standardet e politikëbërjes dhe reforma ushtarake.

Këshilli i Europës (**KE**) është organizata politike më e vjetër e kontinentit, e themeluar në 1949. Ajo ka grupuar 46 vende, 21 nga të cilat janë vende të Europës Lindore e Qendrore. Mbledhja e KE-së në Vienë më tetor 1993 caktoi qëllime të reja politike – organizata u orientua si mbrojtëse e sigurisë demokratike – e mbështetur në të drejtat e njeriut, demokracinë dhe zbatimin e ligjit. KE e konsideron sigurinë demokratike një plotësim të rëndësishëm të sigurisë ushtarake dhe një parakusht për stabilitetin e paqen në kontinent. Që nga fillimi i viteve 90-të, KE ka përcaktuar si detyra të veta kryesore:

- Mbështetjen politike dhe ruajtjen e të drejtave të njeriut për demokracinë pas komuniste të Europës;

---

<sup>13</sup> Abuzimi flagrant i të drejtave të njeriut, veçanërisht pranë kufijve të një vendi shumë shpesh ka destabilizuar këta kufij.

- Burim mbështetjeje për të asistuar vendet e Europës Qendrore dhe Lindore për të kryer dhe konsoliduar reformën politike, ligjore e kushtetuese paralelisht me reformën ekonomike;
- Qendër eksperience në fushat si të drejtat e njeriut, demokracia lokale, arsimi, kultura dhe mjedisi;
- Mbrojtëse e të drejtave të njeriut, demokracisë parlamentare dhe zbatimit të ligjit, dhe një
- forum për të hartuar marëveshje në nivel kontinenti për të standardizuar praktikat sociale e ligjore të vendeve anëtare.

Megjithatë, një faktor tjetër që duhet marrë në konsideratë është Politika e përbashkët mbi sigurinë dhe politikën e jashtme e KE-së (**CFSP**). CFSP u krijua si shtylla e dytë e BE-së në Traktatin e vitit 1993 mbi Bashkimin Europian të firmosur në Maastricht. Në Traktatin e vitit 1999 të Amsterdimit u bënë shumë ndryshime dhe që atëhere ka patur zhvillime të shumta në CFSP. U ra dakord që të mbështeteshin në një politikë të përbashkët sigurie e mbrojtjeje (**CESDP**) brenda kuadrit të përgjithshëm të CFSP.

Traktati i Amsterdimit thekson 5 objektiva themelore të CFSP:

- të ruajë vlerat e përbashkëta, interesat themelore, pavarësinë dhe integritetin e Bashkimit Europian në përputhje me parimin e Kartës së Kombeve të Bashkuara;
- të forcojë me çdo mënyrë sigurinë e Unionit;
- të ruajë paqen dhe fuqizojë sigurinë ndërkombëtare,
- të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar, dhe
- të zhvillojë dhe konsolidojë demokracinë dhe zbatimin e ligjit si dhe respektin për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

Traktati identifikon gjithashtu disa rrugë për arritjen e këtyre objektivave:

- përcaktimi i parimeve dhe udhëzimeve të përgjithshme për CFSP;
- vendimet për strategji të përbashkëta ku secila strategji përcakton objektivat e veta, kohëzgjatjen dhe burimet që duhen siguruar nga BE dhe shtetet anëtare. Deri tani, ka strategji të përbashkëta për Rusinë, Ukrainën, Mesdheun dhe Procesin e Paqes në Lindjen e Mesme;
- adoptimi i veprimeve të përbashkëta që kryejnë dhe pozicioneve të përbashkëta që mbajnë shtetet anëtare për sa i përket një pozicioni apo një veprim të caktuar.

Gjithashtu, BE ka përfaqësuar politik, veçanërisht në zonat e krizës apo të konflikteve. Përfaqësues specialë janë caktuar në Liqenet e Mëdhenj (Afrikë); Lindjen e Mesme; Pakti i Stabilitetit; ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (me interes të veçantë për Shqipërinë); Etiopi / Eritrea dhe Afganistan. Këta përfaqësues specialë sigurojnë një lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimet në këto

vende dhe e lejojnë BE-në të ketë një përfshirje aktive në kërkimin e zgjidhjeve afatgjata. Prandaj, është evidente që organizatat dhe institucionet si BE, NATO, OSBE dhe KE po caktojnë prioritetet në aspektet e ndryshme të sigurisë nga pikëpamja ushtarake, ligjore, politike dhe sociale.

Duke ditur rëndësinë qendrore të sigurisë në politikën e jashtme të Shqipërisë do të ishte me vend të krijohet një Drejtori e Politikës së Sigurisë për të caktuar prioritetet, koordinuar veprimet dhe monitoruar çështjet ndërkombëtare të sigurisë pavarësisht nga forumi apo organizata në të cilën ngrihen ato.

**Rekomandimi 2:-** Duhet krijuar një drejtori e Përgjithshme për Çështjet politike e të sigurisë (**DPÇPS**), që të raportojë drejtpërdrejt tek Sekretari i Përgjithshëm. Përgjegjësia kryesore e saj do të ishte zbatimi i Objektivave Strategjikë 1, 2 dhe 4.

**Rekomandimi 3:** Duhet krijuar një Drejtori e Politikës së Sigurisë (DPS) që të jetë në varësi të DPÇPS: specialistët e kësaj drejtorie do të kenë përgjegjësinë për të ndjekur aktivitetet e OSBE dhe KE-së. Drejtori i Politikës së Sigurisë do të monitorojë CFSP dhe CESDP dhe do të menaxhojë edhe MAP (pra, anëtarësimin në NATO) si dhe çështje të tjera që lidhen me sigurinë si Terrorizmi Ndërkombëtar, Trafikimi i Qenieve Njerëzore, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, Të drejtat e Njeriut, Zbatimi i Ligjit. Përgjegjësia kryesore e DPS-së do të jetë zbatimi i aspekteve të sigurisë të objektivit strategjik 1.

### **3.2 Marëdhëniet Dypalëshe**

Mbajtja e marëdhënieve të mira dypalëshe me shtetet e tjera është një funksion kryesor i Ministrisë së Punëve të Jashtme; funksionet kryesore të Drejtorisë së Marëdhënieve Dypalëshe të MPJ duhet të jenë:

- i. Monitorimi i zhvillimeve ndërkombëtare dhe dallimi i këtyre çështjeve me interesi direkt apo indirekt për Shqipërinë;
- ii. Përgatitja e informacioneve apo dosjeve për Ministrin apo zyrtarët e tjerë të lartë të MPJ, veçanërisht në lidhje me personalitetet që vizitojnë vendin apo vizitat jashtë vendit nga stafi i MPJ;
- iii. Lidhja me ambasadat shqiptare jashtë vendit për probleme të ndryshme që kanë të bëjnë me zonat gjeografike që ato monitorojnë;
- iv. Mbajtja e kontakteve në nivelet e duhura me ambasadat e huaja në Tiranë dhe të
- v. Të ndjekë takimet me delegacionet dhe diplomatët e huaj dhe të prezantojë pozicionin e Shqipërisë mbi çështje të ndryshme politike.

Sidoqoftë, tani që Shqipëria ka finalizuar marrëveshjen e Asociimit me BE-në dhe është një anëtar aspirues i Unionit, është e këshillueshme të ndahen marëdhëniet dypalëshe “tradicionale” nga menaxhimi i marëdhënieve me Shtetet anëtare të BE-së. Thellësia e marëdhënieve dhe domosdoshmëria e koordinimit të politikës së jashtme me BE-në krijojnë nevojën për një strukturë të ndryshme

brenda MPJ që të sigurojë vazhdimësinë e marrëdhënieve dypalëshe me shtetet që nuk janë anëtare të BE-së, por i jep rëndësinë dhe vëmendjen e merituar Bashkimit European. Gjithashtu (e në mënyrë paradoksale) duke ditur që Shqipëria nuk është akoma anëtar i Bashkimit, MPJ është e detyruar ta shohë BE-në si një aktor të jashtëm në politikën e jashtme. Përveç dispozitave të CSFP (shih më lart), BE vepron, në nivele të ndryshme efektiviteti si një i tërë i bashkuar në disa aspekte të politikës së jashtme. Një shembull midis shumë të tjerëve është rasti i Indisë.

BE dhe India kanë bërë marrëveshje të gjera mbi çështje si negocijimi i një marrëveshjeje transporti detar BE-Indi; diskutime për një marrëveshje horizontale mbi aviacionin civil; përcaktimi i anëtarëve të një Tryeze të Rrumbullakët të sapo krijuar “BE-India CEO”; Dialogu BE-India mbi punësimin dhe çështjet sociale; çështje të politikës industriale; mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale; marrëdhëniet dypalëshe mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike; shkenca dhe teknologjia; arsimi; shkëmbimet e shoqërisë civile dhe bashkëpunimi kulturor si dhe programimi i asistencës së zhvillimit European në Indi. Ka gjithashtu edhe një dialog politik shumë intensiv midis dy palëve; Komisioni European ka rënë dakord për pesë ‘mekanizmat’ për forcimin e marrëdhënieve politike me Indinë që përfshijnë:

- Takimet e zyrtarëve të lartë;
- Takimet midis komisionit dhe planifikuesve Indianë;
- Takimet dypalëshe në kufijtë e forumeve shumëpalëshe (me fokus mbi armët biologjike e toksikologjike);
- Grupe pune specialistësh (fokus mbi kontrollin mbi eksportin, terrorizmin dhe çështjet konsullore);
- Krijimi i një ‘rrjeti think-tank’.

Samiti BE-Indi i 28 qershorit 2000 në Lisbonë ka vendosur që të mbahen takime ministeriale çdo vit; takime të zyrtarëve të nivelit të lartë dy herë në vit dhe Samite periodike.

BE ka patur qasje afërsisht të ngjashme (megjithëse me prioritete të ndryshme) me vende të ndryshme si Kanada, Kili, Meksika, Moldavia dhe Rusia<sup>14</sup>, përveç pasjes së një numri marrëveshjes shumëpalëshe me organizata si Mercosur<sup>15</sup> në Amerikën Latine.

Një iniciativë tjetër e BE-së që ia vlen të përmendet është Politika e Fqinjësisë Europiane (**ENP**). ENP u krijua në kontekstin e zgjerimit të BE-së në vitin 2004

---

<sup>14</sup> Marrëdhëniet e BE-së me Rusinë zhvillohen përmes një Partneriteti Strategjik që mbulon 4 “hapësira të përbashkëta”.

<sup>15</sup> Mercado Comun del Cono Sur (Tregu i Përbashkët i Cono–s Jugor).

me objektivin për të shmangur krijimin e linjave të tjera të ndarjes midis BE-së së zgjeruar dhe fqinjëve të vet dhe në vend të tyre të punohej për forcimin e stabilitetit, sigurisë dhe mirëqënies për të gjithë palët e interesuara. Fillimisht, ENP u mendua që të aplikohet vetëm për fqinjët më të afërt të Bashkimit – Agjeri, Bjellorusi, Egjipt, Izrael, Jordani, Liban, Libi, Moldavi, Marok, Autoriteti Palestinez, Siri, Tunizi dhe Ukrainë. Në vitin 2004 kjo politikë u shtri edhe në vendet e Kaukazit Jugor me të cilët vendet aktualisht kandidate Bullgaria, Rumania dhe Turqia kanë kufij të përbashkët detarë dhe tokësorë (Armenia, Azerbajxhani dhe Gjeorgjia).

Një element kryesor i ENP-së janë Planet e veprimit dypalësh të aprovuar si nga BE ashtu edhe nga çdo vend partner. Këto plane caktojnë një program të reformave politike dhe ekonomike me prioritetet afat shkurtër dhe afatmesme. Aktualisht, ka filluar zbatimi i 7 planeve të para të veprimit ENP (të aprovuara në fillim të vitit 2005 me Izraelin, Jordaninë, Moldavinë, Marokun<sup>16</sup>; Autoritetin Palestinez, Tunizinë dhe Ukrainën). 5 plane të tjera veprimi të ENP janë duke u negociuar me Armeninë, Azerbajxhanin dhe Gjeorgjinë, Egjiptin dhe Libanin.

Është e qartë që në të ardhmen, politika e jashtme e Shqipërisë duhet të informohet dhe të ndikohet nga politika e marëdhënies të jashtme të BE-së, veçanërisht kur merren në konsideratë funksionet kryesore (i) dhe (ii) të një Drejtorie të Marëdhënies Dypalëshe siç jepet më poshtë.

**Rekomandimi 4:** duhet krijuar një Drejtori e Marëdhënies Dypalëshe (**DMD**) në varësi të DPÇPS; kjo drejtori do të jetë përgjegjëse për mbajtjen e marëdhënies dypalëshe me shtetet që nuk janë anëtare të BE-së dhe për të monitoruar zhvillimet e marëdhënies të jashtme të BE-së dhe ndikimit të tyre të mundshëm mbi objektivat e politikës së jashtme të Shqipërisë.

### **3.3 Marëdhëniet me Europën**

Objektivat e Politikës së Jashtme të Shqipërisë përqëndrohen në progresin drejt integritit Euro-Atlantik dhe për të qenë një aspirant për statusin e hyrjes në BE. Shqipëria duhet që me çdo kusht të caktojë prioritetet në marëdhëniet e saj me BE-në dhe fqinjët e saj më të afërt. Historia, gjeografia dhe ekonomia e vendit diktojnë që marëdhëniet dypalëshe me fqinjët më të afërt duhet të marrin rëndësi të veçantë. Struktura aktuale e MPJ reflekton këtë realitet: Drejtorja për Vendet Fqinje (**DVF**) është ndarë nga DP për marëdhëniet dypalëshe dhe raporton direkt tek Sekretari i Përgjithshëm. Gjithashtu, një farë ndarjeje karakterizon DP për Marëdhëniet Shumëpalëshe): Drejtorja e Iniciativave fokusohet tërësisht në forumet shumëpalëshe që lidhen me Ballkanin dhe fqinjët e Shqipërisë. Megjithatë, kjo strukturë ka një sërë dobësish:

- Një ndër seksionet në varësi të DVF merret edhe me marëdhëniet dypalëshe me Greqinë dhe Italinë; që të dy këto vende janë Shtete

---

<sup>16</sup> ENP për vendet e Mesdheut quhet 'Euromed', një shkurtime për 'Partneritetin Euro-Mesdhetar'.

anëtare të BE-së dhe si rrjedhim marrëdhëniet e Shqipërisë me ta duhet të marrin një dimension të rëndësishëm që të tejkalojë çështjet e thjeshta të rajonit – ato duhet të modelohen brenda kontekstit të BE-së;

- I njëjti seksion merret edhe em marrëdhëniet me Turqinë, megjithëse nuk ka shumë kuptim se pse seksioni që merret me Italinë (përveç një afërsie gjeografike) duhet të merret edhe me Turqinë.;
- Ndarja e iniciativave rajonale shumëpalëshe si SP, CEI, BSEC, SEECIP dhe AII nga politika dypalëshe në të njëjtën zonë gjeografike është artificiale dhe jo produktive; MPJ duhet të përfitojë nga pasja e një grupi specialistësh që merret me politikën rajonale në nivele dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Turqia është klasifikuar si një ‘Shtet që do të hyjë në BE’, e këto shtete së bashku me ato Shtete Europiane që nuk janë anëtarë të BE-së por kanë një marrëdhënie të ngushtë me Unionin (si vetë Shqipëria) meritojnë vëmendje speciale; kjo do të ishte e vërtetë si në sensin që duhet monitoruar nga afër progresi i tyre drejt pranimit (dhe duhet krahasuar me progresin e Shqipërisë) ashtu edhe për t’u siguruar që shtetet e tjera nuk marrin një trajtim më të favorizuar se Shqipëria.<sup>17</sup> Marrëdhëniet dypalëshe me Turqinë mund të menaxhohen nga një seksion i fokusuar në këto shtete, por me një cilësi më të lartë dhe me një numër më të madh njerëzish për të ndjekur marrëdhëniet me këtë vend.

Megjithëse BE është një aktor i politikës së jashtme, çdo shtet ndjek politikën e vet të jashtme me nivele të ndryshme harmonizimi me të gjithë politikën e Bashkimit Europian. Duke patur parasysh që Shqipëria ka pa dyshim objektivat e veta të politikës së jashtme me (të paktën) Shtetet anëtare më të mëdha e më të afërta, është absolutisht shumë i rëndësishëm një seksion i veçantë, që t’i kushtohet tërësisht marrëdhënieve dypalëshe me këto shtete. Ashtu siç është rasti me Turqinë, marrëdhëniet me Greqinë dhe Italinë duhet të trajtohen nga më shumë personel brenda këtij seksioni.

**Rekomandimi 5:** Duhet krijuar një Drejtori e Çështjeve Europiane (DÇE), në varësi të DPÇPS; një pjesë e punës së drejtorisë do të ketë të bëjë me iniciativat dypalëshe dhe shumëpalëshe në Shtetet fqinje, ndërsa një pjesë tjetër do të merret me marrëdhëniet dypalëshe me shtete anëtare të BE-së, shtetet e pranuar dhe Shtetet e tjera Europiane me lidhje të ngushta e në rritje me BE-në.

Kjo strukturë për ‘bërthamën’ politike e të sigurisë së MPJ do të sigurojë që Drejtori i Përgjithshëm për Çështjet e Politikës së Sigurisë do të ketë një pamje të plotë mbi politikën e jashtme të Shqipërisë, duke ditur që të tre drejtorët në këtë sferë të aktivitetit do t’i raportojnë atij/asaj. Kjo do të bëjë që ky drejtor të:

---

<sup>17</sup> Në rast se ndodh kjo, Qeveria mund të reagojë shpejt – një reagim i shpejtë do të ishte i rëndësishëm këtu.

- Monitorojë të gjitha zhvillimet ndërkombëtare dhe të identifikojë se cilat nga to janë të rëndësishme për Shqipërinë
- mbajë, ku është e mundur dhe/ose e dëshërueshme një shkallë konsistence me pozicionet dhe politikat e marëdhënies të jashtme me BE-në.
- të vazhdojë t'i kushtojë vëmendjen e kërkuar fajnëve më të afërt të Shqipërisë dhe Ballkanit Perëndimor në përgjithësi;
- hartojë politika, pozicione dhe iniciativa rezervë që janë të lidhura me njera-tjetrën dhe reflektojnë konsistencën me Objektivat Strategjike 1, 2 dhe 4 të MPJ.

### **3.4 Çështjet Shumëpalëshe dhe Ekonomike**

DPÇPS do të orientohet drejt marëdhënies dypalëshe me shtetet e tjera, që do të thotë që do të merret kryesisht me shtetet e tjera apo ndoshta me rajonet e tjera<sup>18</sup>. Megjithatë, kur bëhet fjalë për marëdhëniet shumëpalëshe dhe ekonomike MPJ duhet të tentojë të merret me Organizatat Ndërkombëtare dhe/ose organizime të vetëgjeneruara, p.sh., një Mision Tregtar në Gjermani.

Një ndër kurthet në të cilat Drejtoria e Çështjeve Shumëpalëshe tenton të bjerë është që ato bëhen si “zyra poste”, p.sh., posta apo informacioni merret nga UNESCO dhe menjëherë dërgohet tek Ministria e Arsimit pa ndonjë ndërhyrje të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kjo tendencë krijohet sepse shumë drejtori të tilla janë të orientuara nga organizata e jo nga problemi. Prandaj, në rast se do të marrim shembullin e Shëndetësisë, drejtoria do të caktonte specialistin që merret me Organizatën Botërore të Shëndetësisë (**OBSH**) për të monitoruar zhvillimet në këtë organizatë. Tundimi për të kaluar tek “pozicioni i postierit” është i dukshëm sepse specialisti thjesht i referon të gjitha çështjet teknike (apo të vështira) tek Ministria e Shëndetësisë dhe më pas thjesht komunikon pozicionin e Ministrisë tek OBSH. Në epokën e komunikimit elektronik të shpejtë, kjo rutinë ka shumë pak vlerë.

Nëqoftëse Drejtoritë Shumëpalëshe duhet t'i shtojnë vlerë Qeverisë, ato duhet të kalojnë nga një qasje e bazuar në organizata në qasjen që bazohet tek çështjet, që do të thotë duke përdorur shembullin e mësipërm, fokusi nuk do të jetë mbi OBSH, por tek “përmirësimi shërbimeve shëndetësore në Shqipëri”.

E njëjta qasje do të duhet kur merremi me Çështjet Ekonomike: ndjekja e punimeve të Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Tregtinë dhe Zhvillimin (**UNCTAD**) është diçka shumë e mirë, por prioriteti duhet të jetë “zhvillimi i ekonomisë Shqiptare”.

---

<sup>18</sup> Megjithëse siguria është një çështje shumëplanëshe, DP do të duhet të bashkëpunojë kryesisht me NATO-n, SHBA dhe BE-në.

**Rekomandimi 6:** Duhet krijuar një Drejtori e përgjithshme për Çështjet Globale dhe ato Ekonomike (**DPÇGE**) që të raportojë drejtpërdrejt tek Sekretari i Përgjithshëm. Përgjegjësia kryesore e saj do të jetë zbatimi i Objektivave Strategjikë 3 & 5.

### **3.5 Çështjet globale**

Duke përqafuar orientimin të bazuar në çështjet, një specialist i Çështjeve Shumëpalëshe duhet të ndryshojë rrënjësisht qasjen e tij/saj. Duke përdorur përsëri shembullin e Shëndetësisë, specialisti duhet të:

- lidhet me Ministrinë e Shëndetësisë për t'u ndërgjegjësuar mbi prioritetet e shërbimeve shëndetësore që ka ministria;
- investigojë se cila organizatë ndërkombëtare apo shtet<sup>19</sup> mund të mbështesë në fusha të një shqetësimi të madh;
- përpiket të fitojë mbështetjen e kërkuar, nëse është e nevojshme, duke përfshirë misione dypalësh/shumëpalësh;
- marrë pjesë në takime dypalëshe/shumëpalëshe dhe të përgatisë informacion për negocijimet në sektorin e shëndetësisë;
- informojë Ministrinë e Shëndetësisë për mundësitë e reja, ekzistuese apo të mundshme nga vendet e tjera që mund të përmirësojnë dhënien e shërbimeve shëndetësore në Shqipëri;
- monitorojë të gjitha zhvillimet në lidhje me organizatat ndërkombëtare aktive në sektorin e shëndetësisë që përfshijnë OBSH, Bankën Botërore, USAID, etj.
- ndjekë zhvillimet e Këshillit të BE-së mbi Punësimin, Politikën Sociale, Shëndetësinë dhe Çështjet e Konsumatorit (**EPSCO**) dhe të sjellë në vëmendjen e drejtorit të gjitha vendimet apo politikat e reja që mund të ndikojnë dhënien e shërbimit shëndetësor në Shqipëri.

Çështjet globale për të cilat është i interesuar një shtet ndryshojnë nga një komb në tjetrin. Kështu, efekti i ndryshimit klimatik në Bangladesh po çon në rritjen e nivelit të detit me 18% në të gjithë territorin e vendit: efekti në Zvicër shkakton një shqetësim të madh në industrinë e skive. Prandaj, varet nga MPJ në bashkëpunim me ministrinë e linjës që të vendosë se cilat çështje janë vërtet të rëndësishme për Shqipërinë dhe cilave mund t'ju jepet një prioritet më i vogël.

Përsa i përket Kombeve të Bashkuar, duhet të mbahet një specialist për të ndjekur zhvillimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të jetë në kontakt të vazhdueshëm me Drejtorin dhe Përfaqësuesin e Përhershëm në New York.

---

<sup>19</sup> Një specialist që orientohet nga çështjet nuk ka pse ta kufizojë veten e të merret vetëm me organizatat ndërkombëtare: në rast se mbështetja mund të merret nga një shtet i vetëm, atëherë duhet shfrytëzuar kjo mundësi.

**Rekomandimi 7:** duhet të krijohet një Drejtori për Çështjet Globale, në varësi të DPÇEG për të hartuar politikat dhe për të bërë rekomandimet në lidhje me çështjet globale që ndikojnë Shqipërinë dhe se si mund të menaxhohen ato në baza dypalëshe e shumëpalëshe.

### **3.6 Çështjet Ekonomike**

Në strukturën aktuale të MPJ ka një Drejtori të Promovimit Ekonomik e Kulturor (**DPEK**). Nuk ka dyshim se diplomacia ekonomike sot është po aq e rëndësishme (në mos më shumë) se sa diplomacia politike. Prandaj është e rëndësishme që specialistët që caktohen në këtë drejtori të kenë detyra të përcaktuara që ndryshojnë nga ato të specialistëve që ju caktohen vetëm punë politike. Këto detyra përfshijnë:

- Përgatitja e materialeve me informacion të përgjithshëm mbi kushtet ekonomike të vendit (vendeve) me interes për biznesin shqiptar;
- Identifikimi i burimeve të informacionit mbi zhvillimin ekonomik në një vend të huaj;
- Sigurimi i të dhënave mbi rrugët alternative të veprimeve të qeverisë dhe drejtimet e politikës ekonomike në vendin pritës;
- Dhënia asistencë për komunitetet e biznesit lokal dhe përfaqësuesit e biznesit shqiptar që vizitojnë një vend për zhvillimet ekonomike të vendit pritës (p.sh., ndryshimet në treg, anët e forta dhe perspektivat e monedhës, politikat ekzistuese për import/eksportet, etj.);
- Shqyrtimi i politikave të jashtme qeveritare mbi ekonominë, veprimet dhe motivimet për të përcaktuar impaktin e tyre mbi interesat tregtarë të Shqipërisë;
- Kontaktimi i zyrtarëve të qeverive të huaja për mbështetjen e legjislacionit dhe politikave që janë të favorshme për firmat shqiptare apo që veprojnë në Shqipëri;
- Përgatitja e raporteve mbi prirjet ekonomike, përputhjen me marëveshjet shumëpalëshe, etj.;
- Sigurimi, me mbështetjen e specialistëve të jashtëm të MPJ, i një programi trajnues shumë të gjerë për të pajisur diplomatët Shqiptarë me aftësitë dhe njohuritë e kërkuara për të promovuar interesat tregtare të Shqipërisë jashtë saj;
- Lidhja dhe veprimi si ndërmjetësi kryesor midis ambasadave shqiptare dhe agjencive qeveritare e rregullatorëve që përfshihen në zhvillimet e Ekonomisë Shqiptare.

Në lidhje me promovimin kulturor, është një bindje e përgjithshme që aktivitetet kulturore të organizuara jashtë vendit tentojnë të rrisin shkëmbimet tregtare dhe investimet. Kjo është shumë e vërtetë kur flitet për turizimin. Shumë shtete përgjatë pellgut të Mesdheut organizojnë rregullisht shfaqje të valleve popullore

dhe punimeve artizanale gjatë panairove për tregtinë dhe turizimin. MPJ nuk duhet të mbajë koston financiare të këtyre organizimeve, megjithëse ata mund të jenë organizuesit dhe aktorët kryesorë (duke marrë në konsideratë që ka fonde në dispozicion).

Një aspekt tjetër i promovimit kulturor duhet të jetë rritja e kontakteve me Diasporën, dhe mbështetja në të, veçanërisht ata që jetojnë në vende të pasura e të zhvilluara. Sipas Censurit të vitit 2000, në SHBA ka më shumë se 113,000 qytetarë amerikanë me origjinë shqiptare, shumë prej tyre janë të përqëndruar në Shtetin e Massachusetts. Këta individë duhet të 'kultivohen' nga MPJ: DPEK mund:

- Krijojë një listë me shqiptarët e shquar apo të suksesshëm të vendosur në SHBA dhe vendet e tjera;
- Të kërkojë nëse ata përbëjnë një forcë politike në një zonë të dhënë <sup>20</sup> dhe të përpiqet ta shfrytëzojë këtë fakt;
- Bashkëfinancojë një "Dita e Shqipërisë" në një qytet të madh si Bostoni (të ngjashme me Ditën e Shën Patrikut) duke u përpjekur të rrisë imazhin e Shqipërisë dhe në këtë mënyrë të inkurajojë turizmin dhe investimet.

DPEK duhet të kontribuojë në vendimmarrje kur bëhet fjalë për hapje ambasadash jashtë vendit (apo mbajtje/mbyllje e atyre që ekzistojnë). Një nga problemet me të cilat mund të përballet DPEK është që shumë kryeqytete të shteteve nuk janë domosdoshmërisht vendi më i mirë për të bërë biznes në atë shtet. Kryeqyteti tregtar i Italisë nuk është Roma, por Milano. Shumë pak biznes është bërë në Berlin apo Washington DC, ndërkohë që Frankfurti, Stuttgarti, New York-u dhe Silicon Valley janë qytete tregtare. DPEK mund të marrë në konsideratë hapjen e një zyre të orientuar nga turizmi në Hamburg, apo hapja e një zyre të orientuar drejt Investimeve të Huaja Direkte në Milano<sup>21</sup> do të kishte më shumë vlerë për Shqipërinë se sa Ambasadat në Argjentinë dhe Malejzi.

Organizata Botërore e Tregtisë (**OBT**) nuk është në përgjegjësinë e MPJ. Megjithatë nuk është diçka e pazakontë për Ministrinë e Punëve të Jashtme që të ngarkohen edhe me tregtinë me jashtë<sup>22</sup>. Duke ditur që Ministria ka një mision diplomatik në Gjenevë (ku është edhe OBT) ka kuptim që MPJ të marrë përsipër këtë përgjegjësi dhe të lejojë që DPEK të monitorojë zhvillimet atje dhe të hartojë dokumenta për pozicionin e MPJ në lidhje me çështjet e vazhdueshme tregtare dhe me "Doha Development Round".

---

<sup>20</sup> 100,000 votues në zonën e Bostonit nuk është ndonjë numër i pakonsiderueshëm dhe kongresmenët e SHBA të zgjedhur nga ajo zonë mund të kenë një interes për Shqipërinë dhe mirëqënien e ardhshme të saj.

<sup>21</sup> Punonjësit e këtyre zyrave duhet të jenë këshilltarë tregtarë.

<sup>22</sup> Modeli i zakonshëm në Europë është që Ministri për Tregtinë e Jashtme është i ri ose një Zëvendës Ministër i cili raporton tek Ministri i Punëve të Jashtme.

**Rekomandimi 8:** Drejtoria e Promovimit Ekonomik dhe Kulturor duhet të mbahet dhe të vendoset në varësi të DPÇGE; ajo duhet të fokusohet në Objektivin Strategjik 3 dhe të ndjekë nga afër zhvillimet dhe politikat e OBT-së.

### **3.7 Shërbimet për Trupin Diplomatik**

Ashtu siç theksohet më lart, origjina e kësaj drejtorie është në një periudhë të ndryshme të Historisë së Shqipërisë. Sidoqoftë, rëndësia aktuale e saj në MPJ është e diskutueshme. Qëllimi kryesor i MPJ është të drejtojë Punët e Jashtme dhe jo të menaxhojë pasurinë apo të japë shërbime të ndryshme për diplomatët. Ky funksion është kryesisht një shërbim korporate dhe si rrjedhim duhet të jetë pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Korporatës.

**Rekomandimi 9:** në afat të shkurtër, Drejtoria e Shërbimeve për Trupin Diplomatik duhet të vendoset në varësi të Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse. Megjithatë, në mundësinë më të afërt, MPJ duhet t'ia japë këtë funksion një Ministrie tjetër, së cilës i përshtatet më shumë menaxhimi i pasurisë publike.

### **3.8 Çështjet Konsullore, Ligjore dhe Protokolli**

Funksionet Konsullore dhe të Protokollit janë të ndara dhe të dallueshme nga njëri-tjetri. Nuk shihet ndonjë ndryshim në strukturën aktuale të bazuar në drejtori të ndara. Megjithatë, është e mundshme të konsolidohen Çështjet Ligjore në një Drejtori të Përgjithshme.

#### **3.8.1 Çështjet ligjore**

Megjithëse funksionet e Zyrës së Përfaqësuesit Ligjor janë krejt të dallueshme nga ato të Drejtorisë së Ligjeve e Traktateve (që do të thotë, konfliktet gjyqësore ndaj punës së traktateve) kërkohet i njëjti formim ligjor dhe njohuri mbi ligjin ndërkombëtar që kërkohet edhe nga juristët dhe stafi që punon në këto njësi. Megjithatë, normalisht mendohet që përgjegjësia për mbrojtjen e qeverisë dhe/ose ndjekja e një rasti për qeverinë është jashtë Ministrisë së Punëve të Jashtme. Objektivat Strategjike të MPJ, si ato aktualë ashtu edhe ato që propozohen në **Aneksin A**, nuk përmendin konfliktet ndërkombëtare apo mbrojtje të qeverisë në gjykatat ndërkombëtare.

Kështu, është e mundur që institucionet e drejtësisë (p.sh., Avokati i Shtetit), pas një farë kohe, mund të krijojnë një zyrë ligjore, në gjendje për t'u marrë me probleme të kësaj natyre. Kjo duhet marrë në konsideratë.

**Rekomandimi 10:** propozohet që si hap ndërmjetës Zyra e Përfaqësimit Ligjor të jetë në Përgjegjësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve Ligjore dhe Politikave Konsullore. Drejtoria e Ligjeve e Traktateve duhet të mos ekzistojë më si e tillë dhe të zëvendësohet me një Drejtori të Çështjeve Ligjore që do të mbikqyrë si punën për traktatet ashtu edhe atë ligjore/për konfliktet në gjykatat ndërkombëtare. Në një stad të mëvonshëm, përgjegjësia për mbrojtjen/ndjekjen

penale të dokumentave ligjore të qeverisë duhet t'i kalojë institucioneve të tjera të drejtësisë.

### **3.8.2 Çështjet Konsullore**

MPJ ka caktuar Konsuj të Përgjithshëm në qytetet e afërta si Milano, Stambolli dhe Selaniku, etj. Qëllimi kryesor këtu është që të ofrohen shërbime konsullore për shqiptarët që punojnë e jetojnë jashtë në këto qytete e në zonat përreth. Në qytetet ku mungon mbulimi diplomatik apo i Konsullatës së Përgjithshme, MPJ, si të gjitha Ministritë e tjera të Punëve të Jashtme, cakton Konsuj Nderi<sup>23</sup>. Shumë shpesh, këto konsuj caktohen që të mbështesin me shërbime konsullore shqiptarët jashtë vendit. Sidoqoftë, një vend relativisht i vogël si Shqipëria, duhet të marrë në konsideratë modifikimin e konceptit për caktimin të Konsujve të Nderit në një mënyrë të tillë që ta bëjë këtë rrjet një zgjerim të shërbimit të saj diplomatik. Konsujt e nderit mund:

- Organizojnë aktivitete që promovojnë tregtinë dhe investimet e huaja direkte në komunitetet e tyre;
- Të japin mbështetje në ngritjen e industrisë shqiptare të turizmit;
- Të veprojnë si një ndërmjetës me Diasporën vendase të shquar me synimin për zhvillim ekonomik dhe investime në Shqipëri, dhe
- Të udhëheqë delegacionet tregtare në Shqipëri të përbërë nga njerëz të biznesit nga komunitetet dhe qytetet e tyre.

Duhet mbajtur parasysh që Konsujt e Nderit kanë bizneset apo problemet e tyre profesionale që duhet të menaxhojnë dhe kjo përbën interesin kryesor të tyre. Megjithatë, një aktivitet i vetëm promociional i organizuar një herë në dy vjet nga secili Konsull Nderi në vendet e zhvilluara çon në një numër të rritur të aktiviteteve.

**Rekomandimi 11:** Drejtori i Përgjithshëm i Çështjeve Konsullore dhe Ligjore së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm për Çështjet Globale dhe Ekonomike dhe Drejtorin për Promovimin Ekonomik e Kulturor duhet të krijojnë një komitet brenda ministrisë për të përcaktuar se cilat kritere duhen përdorur kur përzgjedhen Konsujt e Nderit dhe fusha e aktivitetit ekonomik që ata janë më shumë në gjendje të promovojnë.

### **3.9 FunkSIONET ADMINISTRATIVE**

Funksionet qendrore administrative të ministrisë janë Financa dhe Buxheti, Auditimi i brendshëm, Burimet Njerëzore, Protokoll-Arshiva, Magazinat & Blerjet, Mbështetja e Teknologjisë së Informacionit dhe Menaxhimi i Pasurisë Qeveritare

---

<sup>23</sup> Këta janë zakonisht shtetas të vendit në fjalë dhe biznesmenë apo profesionistë më emër të mirë në komunitetin e tyre. Ata kanë biznesin e tyre apo lidhje të tjera me shtetin për të cilin veprojnë si Konsuj Nderi.

të përdorur nga Diplomatët e Huaj. Emri aktual i drejtorisë që mbikqyr funksionin e fundit, “Shërbimet për Trupin Diplomatik” do të mbahet për hir të konsistencës, megjithëse funksioni aktual ka të bëjë tërësisht me pronën.

**Rekomandimi 12:** Duhet të caktohet një Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse që të raportojë direkt tek Sekretari i Përgjithshëm. Ai do të menaxhojë të gjitha funksionet administrative të ministrisë. Drejtoria do të ketë dy seksione: një që mbulon shërbimet e “brendshme” si Kontabiliteti, Buxheti dhe Burimet Njerëzore; dhe tjetri që do të merret me shërbimet e “jashtme”<sup>24</sup> që përfshijnë Mbështetjen e TI, Magazinat & Blerjet dhe Shërbimet për Trupin Diplomatik.

### 3.9.1 Financa, Buxheti dhe Auditimi i Brendshëm

Megjithatë Drejtoria e Financës dhe Buxhetit drejtohet në mënyrë konvencionale, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm meriton më shumë vëmendje. Është e vërtetë që kjo drejtori “ekspozon” (në mungesë të një fjale më të mirë) disa mijra Euro në vit parregullsi financiare<sup>25</sup>. Megjithatë, kjo shifër duhet parë në kontekstin e përgjithshëm të buxheteve të caktuara për misionet jashtë vendit.

Shuma totale e buxhetuar çdo vit për të 34 misionet në Europë është €6,276,600 pra mesatarisht nën €185,000 për Mision. Kur mendohet që kjo shifër mbulon pagat, dietat, qiranë, karburantin, pagesat për energji elektrike, ujë, pritjet, mobilimin, telekomunikacionin, etj., është menjëherë e qartë që kjo është një shifër shumë e ulët. Buxheti total i caktuar për Misionet që nuk janë në Europë është €1,245,250<sup>26</sup>; kjo do të thotë që alokimi vjetor total për të gjitha misionet është €7,521,850. Në rast se do të dyfishohej në mënyrë arbitrare shifra e vlerësuar për parregullsitë financiare në €60,000 e t’ia atribuosh të gjitha kundravajtjet Misioneve jashtë shtetit, atëherë ato përfaqësojnë rreth 0.8% të të gjitha shpenzimeve të alokuara për këto misione. Vihet në dyshim vlera e vërtetë e një drejtorie që ka të punësuar tre punonjës që udhëtojnë në Europë, Amerikë të Veriut e Jugut dhe Azi për të zbuluar 4/5 e 1% të parregullsive të mundshme që krijohen nga një buxhet shumë i vogël. Megjithëse mund të argumentohet që heqja e kësaj drejtorie mund të çojë në rritje të abuzimeve financiare, buxhetet aktuale janë aq të vogla, sa është shumë e vështirë të perceptosh shkallën e mashtrimit që kërkohet nga diplomatët shqiptarë në mënyrë që të përfitojnë personalisht në masë të konsiderueshme si pasojë e keqpërdorimit ose abuzimit me fondet e ambasadës. Por në fakt, do të kishte më shumë kuptim në rast se Ambasadave do t’ju kërkoheshin të dërgonin faturat origjinale të shpenzimeve në

---

<sup>24</sup> Shërbimet konsiderohen të “jashtme” nëqoftëse stafi që i kryen ato duhet të merret nga jashtë për të ofruar shërbimin, p.sh., blerja e mallrave jashtë ministrisë, riparimi i një ndërtese të zënë nga një ambasadë e huaj.

<sup>25</sup> Megjithatë si Sekretari i Përgjithshëm ashtu edhe Drejtori i Financës e Buxhetit e venë në diskutim parregullsinë e vërtetë të transaksioneve të raportuara.

<sup>26</sup> MPJ raporton që buxhetet vjetore për vitin 2006 për New York, Buenos Aires, Tokio, Kuala Lumpur, Tel Aviv, Pekin, Riad, Ottawa, Washington dhe Kajro arrijnë në \$1,494,300; më shumë se gjysma e kësaj shifre i jepet misioneve të Amerikës së Veriut.

MPJ, gjë që aktualisht atyre nuk ju është kërkuar ta bëjnë. Për më tepër, është shumë e vështirë t'i largohesh përshtypjes që burimi i problemit është pikërisht fakti që kaq pak para janë shpërndarë në numrin e shumtë të ambasadave. Drejtori i Auditimit të Brendshëm dhe stafi i tij shprehën shqetësimin që disa diplomatë shqiptarë mund të tundohen të marrin banesa me qira të ulët dhe në bashkëpunim të mundshëm me pronarët e tyre, të marrin një pjesë të pagesës së qirasë për veten e tyre. Megjithatë, një krahasim i thjeshtë i pagesave të qirave për Shërbimin Diplomatik Shqiptar me kostot mbizotëruese të akomodimeve në qytetet si Londra, Brukseli, New York dhe Gjeneva do të zbulojnë shumë shpejt që diplomatët shqiptarë përballohen me zgjedhjen e vështirë midis një ushqimi të dobët dhe një akomodimi të papërshtatshëm.

Ashtu siç është theksuar më lart, mbase do të ishte më efektive të hidhet një vështrim më i hollësishëm në rrjetin aktual të ambasadave dhe të merret në konsideratë reformimi i tij: pjesa e kursimeve të bëra mund të përdoret për përmirësimin e pagave që marrin diplomatët e MPJ si dhe një rënie në abuzimet e vogla.

**Rekomandimi 13:** Auditimet *in situ* (në vend) të ambasadave jashtë shtetit duhet të bëhen me aprovimin direkt të Sekretarit të Përgjithshëm kur ka një arsye të mjaftueshme që për shkak të kapaciteteve të lira buxhetore mundësohet abuzimi serioz..

### **3.9.2 Shërbimet e Informacionit**

Drejtoria e shtypit dhe Diplomacisë Publike mbikqyr dy funksione krejtësisht të ndryshme: mbështetjen teknike të TI; dhe, bashkëpunimin (në mënyra të ndryshme) me Shtypin. Është e vështirë të gjendet një lidhje midis këtyre dy funksioneve. Një aktivitet është krejtësisht teknik, tjetri tërësisht politik.

**Rekomandimi 14:** Drejtoria e Shtypit dhe Diplomacisë Publike duhet të mos ekzistojë më në këtë formë. Mbështetja teknike për TI është një funksion mbështetës i korporatës dhe duhet bashkuar me përgjegjësinë e Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse. Të gjitha marrëdhëniet me Shtypin, që përfshijnë edhe dhënie e lajmeve të përditshme për Misionet jashtë shtetit, duhet të jenë përgjegjësi e Koordinatorit të Komunikimit në Kabinetin e Ministrit dhe nën varësinë e kontrollin direkt të Shefit të Kabinetit apo të një Zëvendës Ministri.

## **4.0 Çështje të tjera**

### **4.1 Ambasadat dypalëshe**

Sapo një shtet bëhet anëtar i një organizate ndërkombëtare (p.sh., Kombet e Bashkuara), ai shtet është pothuajse i detyruar që të krijojë një Mision për atë organizatë pranë zyrave qendrore të saj dhe të caktojë një Përfaqësues të Përhershëm. Megjithatë, krijimi i ambasadave dypalëshe është çështje zgjedhjeje, sepse një ambasadë dypalëshe në një shtet krijohet sepse marrëdhëniet me atë shtet konsiderohen shumë të rëndësishme e që meritojnë

një Mision në kryeqytetin e atij vendi. Megjithëse qëllimi i disa ambasadave dypalëshe të Shqipërisë është i vetëkuptueshëm, p.sh., Athina, Roma, Shkupi, arsyeja për krijimin e disa misioneve të tjera është më pak e kuptueshme. P.sh., është e paqartë se përse aktualisht kërkohet përfaqësim i plotë në Buenos Aires dhe Kuala Lumpur. Gjithashtu, duket sikur nuk është ruajtur parimi i reciprocitetit me MPJ. E në fakt, as Argjentinasi dhe as Malezianët nuk kanë ngritur ambasada në Tiranë: të dy këto vende e mbulojnë Shqipërinë nëpërmjet ambasadës së tyre në Romë.

Krijimi dhe mbajtja e ambasadave jashtë shtetit kushton shumë dhe vendet në zhvillim apo ekonomitë në tranzicion duhet të presin që çdo mision të paguajë për veten e tij në kuptim të përfitimeve politike dhe/apo ekonomike të marra dhe mundësisht dhe si rezultat i frekuencës dhe kërkesës për shërbime konsullore . Kur merret në konsideratë hapja e një ambassade të re (ose nëse një mision ekzistues duhet mbajtur apo jo) duhen marrë parasysh disa çështje:

- Potenciali për investimet e huaja direkte
- Potenciali për të vlerësuar tregun për turistët
- Potenciali për Eksportet Shqiptare
- Kontakte politike me vlerë
- Shteti i synuar ka një Ambasador rezident në Shqipëri
- Fuqi lobuese në rritje mbi çështje të rëndësishme për Shqipërinë
- Kostot e kapitalit dhe ato të vazhdueshme për të krijuar ambasadën

Në përputhje me prioritetet e Shqipërisë mund të merren parasysh edhe çështje të tjera dhe secilës mund t'i jepet një vlerësim, pra mund të përdoret një sistem pikësh të peshuara. Ato ambasada që arrijnë një prag të përcaktuar “kalimi” duhet të hapen. Ato që nuk e kalojnë këtë prag duhet të mos jenë më prioritet. Në fakt, aplikimi i këtij sistemi për ambasadat që aktualisht ekzistojnë mund të japë rezultate interesante dhe mund të çojë në një fokusim më të madh tek ato ambasada që mendohet që nuk po funksionojnë siç duhet.

Shembull: Ambasada në Berlin (pragu i kalimit: 350 pikë):

Kriteri	Pesha	Rezultati	Totali
Potenciali i IHD	10	10	100
Potenciali Turistik	10	10	100
Potenciali i Ndihmës së Huaj	8	10	80
Eksportet Shqiptare	8	6	48
Përfaqësimi në Tiranë	7	10	70

Fuqi në rritje lobimi (çështje vitale për interesin kombëtar)	6	7	42
Përmirësimi i marrëdhënieve me BE	6	7	42
Kosto kapitale & të vazhdueshme	-7	9	-63
<b>Totali</b>			<b>419</b>

**Rekomandimi 15:** MPJ duhet të prezantojë një sistem zyrtar vlerësimi apo renditjeje që mund të përdoret si një instrument vendimmarrjeje kur merret në konsideratë hapja e një ambasade të re dypalëshe.

## 4.2 Akademia e Diplomacisë

Struktura aktuale e MPJ përfshin një Akademi Diplomacie<sup>27</sup>, Drejtuesi i së cilës raporton direkt tek Ministri i PJ. Është pa dyshim e vërtetë që trajnimi i vazhdueshëm i diplomatëve është një domosdoshmëri absolute në një mjedis ndërkombëtar që karakterizohet nga ndryshimi i shpejtë si në sferën politike ashtu edhe në atë ekonomike. Megjithatë, pas arritjes të një niveli njohurish bazë të Konventave kryesore dhe praktikave ndërkombëtare diplomatike, është e vështirë në praktikë të hartosh një kurs studimesh “për të gjithë” i cili të plotësojë nevojat për trajnim të stafit të MPJ. Është e qartë që disa diplomatë kanë nevojë për të ndjekur kurse të gjuhëve të huaja si Anglisht, Frëngjisht, Gjermanisht dhe gjuhë të tjera që vlerësohen të rëndësishme për punën diplomatike të ardhshme. Të tjerë mund të kenë nevojë për edukim më të specializuar në fusha si Ekonomiks, Tregti dhe Financa ndërkombëtare, Ligji ndërkombëtar, studime mbi Zhvillimin, etj.

Gjithashtu, përfshirja e Akademisë në strukturën e ministrisë nuk lejon që ajo të jetë e pavarur nga qeveria, një pavarësi që normalisht kërkojnë institucione të tilla, në mënyrë që të jenë gjithnjë relevantë dhe novatorë. Kjo pavarësi mund të balancohet duke lejuar qeverinë të përcaktojë aftësitë që duhet të zotërojnë diplomatët e saj.

**Rekomandimi 16:** propozohet që Akademia e Diplomacisë të mos ekzistojë më si e tillë. Ajo të zëvendësohet nga një Komitet intrministerial mbi Zhvillimin e Stafit i drejtuar nga një prej Zëvendës ministrave: ky komitet do të shqyrtojë kërkesat për trajnim të shërbimit diplomatik, do të përcaktojë se cilët diplomatë kërkojnë trajnim të mëtejshëm dhe në cilat fusha dhe do të identifikojë

<sup>27</sup> E krijuar me VKM Nr. 198, 14 prill 2004


universitetet dhe institucionet trajnuese (vendase e të huaja) që mund të ofrojnë kurse të përshtatshme me kohë të plotë apo të pjesshme.

\* \* \* \* \*

Struktura e propozuar e MPJ jepet në faqen e mëposhtme. Në këtë strukturë tek Sekretari i Përgjithshëm raportojnë vetëm tre drejtorë të Përgjithshëm dhe dy drejtorë; funksionet e politikëbërjes, ekonomike, konsullore, protokolli dhe ato administrative janë grupuar së bashku për të dhënë një strukturë logjike, të thjeshtë dhe të plotë që kufizon hapësirën menaxhuese të Sekretarit të Përgjithshëm dhe lejon që MPJ të arrijë objektivat strategjike brenda një strukture që lehtëson koordinimin e iniciativave të ndryshme të ministrisë.

# Ministry of Foreign Affairs

## Proposed Functional Structure



## **Anekse**

## ***Aneksi A***

### **Objektivat Strategjike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë**

## **Aneksi A**

### **Objektivat Strategjikë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë**

Deklarata e Misionit të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) është si më poshtë:

*Ministria e Punëve të Jashtme vepron dhe punon për interesat e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare dhe në të mirë të lirisë, sigurisë dhe mirëqënies së shqiptarëve.*

Objektivat Strategjikë të MPJ janë si më poshtë:

#### **01 Integrimi i Shqipërisë në BE dhe NATO**

MPJ do të angazhohet me integrimin e vendit në strukturat Euro-Atlantike duke mbështetur fuqimisht përmbushjen e standardeve të integrimit nëpërmjet procesit të transformimit politik, ekonomik, social dhe ushtarak.

Aktiviteti diplomatik do të mbështesë dhe shoqërojë punën e qeverisë në kryerjen e reformave të thella e të plota për të cilat ka nevojë ky proces. Nëpërmjet diplomacisë politike dhe ushtarake, Shqipëria do të mbështesë fuqimisht procesin e fuqizimit të aleancave dhe bashkëpunimit strategjik me të gjitha vendet, në kuadër të iniciativave globale mbi sigurinë e njerëzimit dhe zbatimin e reformave si në fushat politike ashtu edhe në ato ushtarake. Për më tepër, për të arritur synimin për integrimin në BE, politika e jashtme e Shqipërisë do të:

- Promovojë bashkëpunimin rajonal, sigurinë dhe begatinë;
- Mbështesë tregtinë e lirë;
- Promovojë politikën e zhvillimit rajonal;
- Eliminonjë krimin e organizuar në vendet e ndryshme dhe trafikun e paligjshëm;
- Zhdukë korrupsionin;
- Inkurajojë transparencën e zhvillimeve vendase politike dhe ekonomike, dhe
- Arrijë progres në çështjet konsullore.

#### **02 Promovimi i stabilitetit rajonal dhe sigurisë në Ballkan dhe Shtetet e tjera fqinje**

MPJ do të synojë sigurinë rajonale, paqen dhe qetësinë si dhe mbrojtjen e interesave kombëtare të vendit. Ministria do të rrisë rolin e Shqipërisë në rajon me synimin për të fuqizuar paqen dhe stabilitetin atje dhe të arrijë një zgjidhje të drejtë për çështjen e Kosovës, zbatimin e Marëveshjes së Ohrit dhe përparimin e marrëdhënieve politike, ekonomike dhe kulturore me të gjitha vendet në rajon. Shqipëria do të intensifikojë marrëdhëniet diplomatike, politike, ekonomike dhe kulturore me të gjitha Shtetet Ballkanike. MPJ do të vazhdojë të mbështesë fuqimisht bashkëpunimin rajonal dhe do të mbështetet në kuadrin e plotë të marrëveshjeve me secilin nga këto vende që e

nënshkruan dhe më pas e ratifikuan nga Parlamenti. Programet praktike dhe realiste të këmbimeve në disa fusha do t'i shtojnë këto marrëveshje. Politika e jashtme shqiptare parashikon një nivel më kuptimplotë të këtyre marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimit me Kosovën, Maqedoninë, Kroacinë, Bosnjë-Hercegovinën, Serbinë, Malin e Zi dhe Shtetet e tjera Ballkanike. Marrëdhëniet tradicionale dhe afatgjata me Turqinë do të vazhdojnë të ushqehen me synimin për të filluar shkëmbime të reja dhe të frutshme.

### **03 Zhvillimi i diplomacisë ekonomike dhe kulturore për arritjen e begatisë materiale për Shqipërinë**

MPJ do ta verë diplomacinë në shërbim të ekonomisë së vendit duke tërhequr investimet e huaja dhe marketuar potencialin ekonomik, kulturor dhe të industrisë së turizmit që ofron vendi.

Shqipëria beson që afrimi midis popujve dhe kombeve arrihet përmes shkëmbimeve ekonomike të rëndësishme dhe të qëndrueshme. Diplomatët shqiptarë duhet të krijojnë një ndërgjegjësim për klimën atraktive që ekziston për bizneset e zotëruara nga të huajt; kjo do të krijojë mundësitë dhe kushtet e duhura për hyrjen e investimeve të huaja dhe një vlerësim më të madh të burimeve natyrore dhe burimeve të tjera ekonomike që Shqipëria mund t'i ofrojë investitorëve të huaj potencialë. Për këtë qëllim, politika e jashtme shqiptare do të përdorë diplomacinë ekonomike me efektivitet të plotë duke siguruar kontakte të trupit diplomatik shqiptar me komunitetin e biznesit dhe të investitorëve të shteteve ku ato janë akredituar.

Diplomacia kulturore shqiptare do të krijohet për të riafrimuar identitetin kombëtar të vendit në lidhje me popujt dhe shtetet e tjerë dhe do të shërbejë për të vënë në pah vlerat e vërteta të kombit, të kultivojë një imazh pozitiv për popullsin shqiptar dhe në një shkallë më të gjerë të integrojë vendin në procesin e vazhdueshëm global të përhapjes në të gjithë botën të vlerave kulturore specifike për vendin. Veçanërisht, diplomacia kulturore do të përdoret si një mjet për të promovuar industrinë e turizmit.

### **04 Promovimi i marrëdhënieve dypalëshe**

MPJ do të kultivojë marrëdhënie të mira dypalëshe midis shteteve, si një bazë për zhvillimet në fusha të ndryshme me përfitim reciprok. Shqipëria do të intensifikojë marrëdhëniet e saj me të gjitha vendet demokratike; administrata aktuale i konsideron marrëdhëniet me SHBA si një prioritet të veçantë dhe me një rëndësi shumë të madhe strategjike për vendin. SHBA konsiderohet si një aleat i pazëvendësueshëm i demokracisë së re shqiptare dhe përveçse do të vazhdojë të jetë një kontribues aktiv në Koalicionin Anti-Terror, qeveria shqiptare do të marrë masa për tërheqjen e investimeve dhe kapitalit amerikan në Shqipëri. Gjithashtu, një numër shtetesh dhe rajonesh kanë një peshë të veçantë në marrëdhëniet ndërkombëtare; këto vende përfshijnë Kinën, Izraelin, Japoninë, Indinë, disa vende të Lindjes së mesme dhe Kanadanë; gjatë viteve të kaluara, këto shtete kanë ndihmë të konsiderueshme dhe konkrete në periudhën e tranzicionit të vështirë. Ndërkohë që një afrim më i madhe me BE mbetet një prioritet madhor, diplomacia shqiptare do të intensifikojë gjithashtu marrëdhëniet dypalëshe me secilin nga shtetet anëtarë të BE-së dhe dhe në veçanti me anëtarët e tij më të mëdhenj

si Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Franca, Italia dhe me shtetet ku ekzistojnë marëdhënie tradicionale si Austria e Greqia..

**05 Promovimi i diplomacisë shumëpalëshe me synimin për të rritur rëndësinë politike të Shqipërisë dhe për të mbështetur iniciativat dhe projektet që çojnë përpara si shtetin ashtu edhe rajonin**

MPJ do të rrisë rolin e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, organizmat, iniciativat shumëpalëshe dhe koalicionet ndërkombëtare, p.sh., Kombet e Bashkuara, Këshilli i Europës, OSBE, Koalicioni Antiterror, UNESCO, Frankofonia me synimin për të çuar më përpara rolin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, për të përmirësuar imazhin e vendit jashtë dhe për ta përfshirë atë në projekte shumëpalësh që përmirësojnë ekonominë shqiptare dhe arrijnë stabilitetin, paqen dhe sigurinë në botë.

**06 Diplomacia shqiptare do të përpiqet të plotësojë nevojat praktike të Shqiptarëve brenda vendit e jashtë tij**

MPJ do të kërkojë të plotësojë nevojat e qytetarëve shqiptarë në të gjithë botën, të punojë për lëvizjen e lirë të qytetarëve të saj dhe të hartojë politika dhe procedura konsullore moderne, eficiente dhe të promovojë interesat e Diasporës kudo që ata të jenë në botë.

**07 Struktura e MPJ do të shqyrtohet vazhdimisht për të siguruar që përballon sfidat e realiteteve aktuale politike e ekonomike**

MPJ është përgjegjëse për zbatimin e këtyre objektivave strategjike. Si rrjesim, ajo do të shqyrtojë vazhdimisht procedurat dhe mekanizmat e brendshëm që përdor si dhe do të përditësojë, kur është e nevojshme, metodat e saj organizative dhe të menaxhimit. Ky proces do të aplikohet gjithashtu edhe për misionet diplomatike jashtë shtetit. Organizimi i MPJ është dhe do të bazohet në interesin kombëtar, objektivat strategjike dhe qëllimet afatmesme e afatgjata.

*Aneksi B*

**Organizatat dhe iniciativat rajonale shumëpalëshe**

## **Aneksi B**

### **Organizatat dhe Iniciativat Rajonale Shumëpalëshe**

#### **01 Pakti i Stabilitetit**

Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore është krijuar (me iniciativën e BE-së) në vitin 1999 për të stimuluar reformën ekonomike dhe politike në Europën Juglindore, pra vendet e Ballkanit perëndimor së bashku me Bullgarinë, rumaninë dhe Moldavinë. Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore është një deklaratë politike angazhimi dhe një marëveshje kuadër mbi bashkëpunimin ndërkomëbtar për të hartuar një strategji të përbashkët për stabilitet dhe rritje në Europën Juglindore. Organi kryesor vendimmarrës i Paktit të Stabilitetit është Tryeza Rajonale e kryesuar nga Koordinatori Special. Ka tre tryeza pune që punojnë në varësi të Tryezës rajonale që merren përkatësisht me Demokratizimin dhe të Drejtat e Njeriut (Tryeza e punës I), Rindërtimi ekonomik (Tryeza e punës II) dhe Çështjet e Sigurisë (Tryeza e Punës III).

Në Dhjetor 2002 u ra dakord për 6 objektiva kryesore të Paktit të Stabilitetit: Media, Demokracia Lokale dhe Bashkëpunimi Ndërkofitar, Kompakti Tregti Ndërrajonale/Investim, Infrastruktura rajonale, Krimi i organizuar, Migrimi dhe Azili/Refugjatët.

#### **02 Iniciativa Qendrore Europiane**

Iniciativa Qendrore Europiane (CEI) ka seline e saj ne Trieste, Itali dhe ka 17 shtete anëtarë: Shqipëri, Austri, Bjellorusi, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Çekia, Hungaria, Italia, Maqedonia, Moldavia, Polonia, Rumania, Serbia dhe Mali i Zi, Sllovakia, Sllovenia dhe Ukraina. Ato zënë një territor prej 2.4 milion km<sup>2</sup> dhe një popullsi afërsisht 260 milion. CEI u krijua në vitin 1989 si një forum ndërqeveritar për bashkëpunim politik, ekonomik dhe kulturor midis shteteve të tij anëtare. Qëllimi kryesor i kësaj iniciative është të ndihmohen vendet në tranzicion në Europën Qendrore që të afrohen me BE. Në gjysmën e dytë të vitit 1990, zgjerimi i anëtarësisë në Europën Juglindore dhe atë Lindore i rifokusoi prioritetet e kësaj iniciatve tek vendet me nevoja të veçanta.

Një ndër objektivat e CEI-t është të afrojë vendet e Europës Qendrore dhe Lindore dhe t'i asistojë ato në procesin e tyre përgatitor për anëtarësim në BE. Pranimi kohët e fundit i 5 Shteteve anëtare të CEI-t në BE e ka drejtuar vëmendjen e CEI në 10 shtetet anëtare që janë jashtë BE-së. Një program i ri i CEI-t është të lehtësohet dhe të bashkëfinancohet transferimi i eksperiencës (knoë-hoë) tek eksperienat e "freskëta" të tranzicionit dhe të negocijimeve.

#### **03 Organizata e bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi**

Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BSEC) u krijua në vitin 1992, anëtarët e tij janë: Turqia, Shqipëria, Bullgaria, Rumani, Moldavia, Greqia, Azerbaixhani, Gjeorgjia, Armenia, Rusia dhe Ukraina. Organizata mbulon 20

milion km<sup>2</sup> me një popullsi totale prej 350 milionësh dhe zë 5% të tregtisë botërore. Ky rajon është i vendosur në korridore të rëndësishëm energjie dhe transporti midis Lindjes dhe Perëndimit. BSEC synon të rrisë bashkëpunimin midis anëtarëve të tij në ekonomi, banka, komunikime, mjedis, bujqësi, energji, shkencë, teknologji, arsim, statistika, shëndetësi, transport dhe në luftën kundër krimit të organizuar. BSEC e ka selinë në Stamboll të Turqisë.

#### 04 Procesi i Bashkëpunimit Europiano Juglindor (SEECP)

Procesi i Bashkëpunimit Europiano Juglindor është një strukturë rajonale bashkëpunimi e pa institucionalizuar. Ajo është krijuar në vitin 1996, kur Bullgaria organizoi një takim rajonal të disa ministrave të punëve të jashtme, për të vënë themelet e një forumi të një bashkëpunimi të ri, pas lindjes së shteteve të reja në Ballkan.

Vendet pjesëmarrëse janë Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Rumania, Serbia e Mali i Zi, Turqia, Bosnja & Hercegovina dhe Kroacia. Disa shtete të tjera (p.sh., Moldavia) kanë status vëzhguesi.

Programi i takimeve të SEECP ka disa tema kryesore si:

- Masa për rritjen e stabilitetit, sigurisë dhe marëdhënieve të mira të fqinjësisë; ;
- Masa për të intensifikuar bashkëpunimin shumëpalësh, ekonomik dhe tregtar në rajon, veçanërisht në lidhje me bashkëpunimin ndërkuftar, përmirësimin e transportit, komunikimit dhe infrastrukturës energjetike, promovimit të investimeve dhe të tregtisë;
- Promovimi i bashkëpunimit në fushat humanitare, sociale dhe kulturore;
- Bashkëpunimi në çështjet e Drejtësisë dhe të Punëve të brendshme, për të luftuar krimin e organizuar, trafikun e paligjshëm të drogave dhe armëve si dhe masat kundër terrorizmit.

#### 05. Iniciativa e Adriatik-Jonit (AII)

7 vendet në Pellgun e Adriatikut dhe Jonit, Shqipëria, Bosnja Hercegovina, Kroacia, Greqia, Italia, Serbia & Mali i Zi dhe Sllovenia, kanë rënë dakord për iniciativën Adriatik-Jon, me firmosjen e Deklaratës së Ankonës me rastin e Konferencës së Ankonës mbi “Zhvillimin dhe Sigurinë në Adriatik dhe Jon” (20 Mars 2000).

Iniciativa bazohet në idenë që krizat ndërkombëtare nuk zgjidhen me anë të dhunës, por nëpërmjet bashkëpunimit reciprok midis popujve të ndryshëm për të identifikuar dhe përcaktuar së bashku një sërë interesash të përbashkëta në të gjithë sektorët.

Nga një pikëpamje moderne, këto interesa kanë të bëjnë me: sigurinë, ekonominë, tregtinë, kërkimin e zhvillimin shkencor e teknologjik, ruajtjen e mjedisit dhe ruajtjen e trashëgimisë dhe vlerave kulturore.

Prandaj, **All** është një forum i dobishëm për të fuqizuar dhe zgjeruar lidhjet ekzistuese midis vendeve të Pellgut të Adriatik -Jonit dhe për të rritur bashkëpunimin në fusha me interes të përbashkët. Në kuadër të **All** është ngritur një Këshill i Adriatik-Jonit në nivel ministerial; vëmendje e veçantë iu dha asistencës dhe bashkëpunimit ekonomik e teknik në menaxhimin e trafikut, mbrojtjen e mjedisit, bashkëpunimin në fushën e kulturës, arsimit dhe turizmit; dhe asistencë reciproke në luftën ndaj të gjitha formave të aktivitetit kriminal/ presidenca e Iniciativës Adriatik –Jon qarkullon midis të 7 vendeve anëtare.